




BISEDË PËRMES HEKURASH ME ISH-PRESIDENTIN HASHIM THAÇI

THAÇI: UNË SOT JAM I PRIVUAR PËRKOHËSISHT, POR POPULLI IM ËSHTË I LIRË PËRJETËSISHT

FAQE 4-5



“Ky është çmimi i përbaljes së mëhershme me tiraninë. Unë sot jam i privuar përkohësisht, por populli im është i lirë përjetësisht

DËSHTON SËRISH KONSTITUIMI
I KUVENDIT TË KOSOVËS

AMBASADORËT E HUAJ
TË ZHGËNJYER PËR
MOSKONSTITUIMIN
E KUVENDIT

F. 9



UJI I PISHINËS SË GËRMISË
ËSHTË NË PËRPUTHJE
ME STANDARDET

F. 7



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË

SHBA-JA SHEH MUNDËSI PËR
BASHKËPUNIM EKONOMIK ME
KOSOVËN, KËRKON HEQJEN E
BARRIERAVE

F. 5

SPORT



SUKSESI I MERITUAR DHE I PRITUR I
ENISE ZIJADES NË EYOF SHKUP 2025

F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Nisin diskutimet për një takim të mundshëm mes presidentit të Ukrainës dhe të Rusisë

PRISHTINË, 25 KORRIK - Delegacioni nga Moska dhe nga Kievi kanë nisur diskutimet për mundësinë e një takimi në mes të presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky dhe homologut të tij rus, Vladimir Putin. Këto diskutime janë zhvilluar gjatë bisedimeve të mbajtura mes këtyre dy delegacioneve në Stamboll më herët gjatë kësaj jave, tha Zelensky në komente të publikuara më 25 korrik. Zelensky po kërkon një takim me Putinin dhe i ka bërë thirrje presidentit amerikan, Donald Trump, i cili po kërkon që palët të arrijnë një marrëveshje, të marrë pjesë në këtë takim. Putini ka thënë se është i

gatshëm të takohet me Zelenskyn, por vetëm gjatë “një faze finale” të negociatave, për t’i dhënë fund luftës që ka nisur mbi tre vjet më parë. “Ne kemi nevojë të ketë përfundim të luftës, dhe kjo me gjasë nis me një takim të udhëheqësve”, tha Zelensky për gazetarët. “Në bisedime me ne, ata kanë nisur ta diskutojnë këtë çështje. Veçse ka përparim drejt një lloji formati të takimit”, shtoi ai. Në raundin e fundit të bisedimeve të mbajtura të mërkurën, Kievi propozoi të mbahen bisedime në fund të gushtit. Kjo kohë është e përafërt edhe me afatin e vendosur nga Trumpi, i cili më herët gjatë këtij muaji i dha Rusisë 50 ditë kohë për të

arritur një marrëveshje të paqes me Ukrainës ose do të përballet me sanksione. Një ditë më parë Kremli e minimizoi mundësinë e një takimi Putin - Zelensky në një periudhë të shkurtër kohore. “Një takim i nivelit të lartë mund dhe duhet të japë një zgjidhje përfundimtare”, tha zëdhënësi i Kremilit, Dmitry Peskov. “A është e mundur të shkohet në këtë proces të ndërlikuar brenda 30-ditësh? Ka pak gjasa të ndodhë”, shtoi ai. Bisedimet për përfundimin e luftës kanë prodhuar pak rezultate. Palët kanë qëndrime krejtësisht të ndryshme dhe Ukraina e ka akuzuar Rusinë se po dërgon në bisedime zyrtarë të nivelit të ulët që nuk kanë



fuqi për vendimmarrje. Rusia i ka bërë thirrje Ukrainës të heqë dorë nga katër rajone që Moska pretendon se i ka aneksuar, një kërkesë që Kievi e ka quajtur të papranueshme.

Ukraina thotë se nuk do ta njohë kurrë pretendimin e Rusisë mbi territoret e pushtuara - përfshirë Krimenë, të cilën Kremli e aneksoi në vitin 2014.

Macroni: Franca do ta njohë shtetin palestinez

PARIS, 25 KORRIK - Franca do ta njohë zyrtarisht shtetin palestinez në shtator, ka thënë presidenti francez, Emmanuel Macron. Kështu, Franca do të bëhet shteti i parë anëtar në grupin e shtatë vendeve më të industrializuara (G7) që merr këtë hap. Përmes një postimi në “X”, Macron ka thënë se njoftimi zyrtar do të bëhet në takimin e përvitshëm të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. “Nevoja urgjente sot është që të përfundojë lufta në Gazë dhe të shpëtohet popullsia civile. Paqja është e mundshme. Neve na duhet armëpushim i menjëhershëm, lirimi i të gjitha pengjeve dhe ndihmë masive humanitare për njerëzit e Gazës”, ka shkruar ai. Zyrtarët palestinezë e kanë përshëndetur vendimin e Macronit, derisa kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu ka thënë se vendimi “shpërblen terrorin”, pas sulmit të Hamasit



në Izrael, më 7 tetor të vitit 2023. Hamas është organizatë e shpallur terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe fuqi tjera. Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, ka thënë se ShBA-ja “kundërshton ashpër” vendimin e Macronit dhe e sheh si të “pamatur”. Grupi G7 përbëhet edhe nga

Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Gjermania, Kanadaja dhe Japonia. Në postimin e tij në “X”, Macron ka thënë se Franca do ta njohë shtetin palestinez në linjë me përkushtimin historik për paqe afatgjatë në Lindje të Mesme. “Ne duhet të garantojmë çarmatosjen e Hamasit dhe rindërtimin e

Gazës”. Macroni e ka bërë publike letrën që ia ka nisur presidentit të Autoritetit Palestinez, Mahmoud Abbas duke e konfirmuar vendimin. Duke iu përgjigjur njoftimit të Macronit, zëvendësi i Abbasit, Hussein al-Sheikh, ka thënë se “ky pozicion reflekton përkushtimin e Francës për ligj ndërkombëtar dhe mbështetjen e saj për të drejtën e popullit palestinez për vetëvendosje dhe themelimin të shtetit tonë të pavarur”, ka raportuar agjencia e lajmeve AFP. Aktualisht shtetin palestinez e njohin më shumë se 140 prej 193 vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara. Disa vende të Bashkimit Evropian, përfshirë Spanjën dhe Irlandën janë në mesin e tyre. ShBA-ja, aleatja kryesore e Izraelit, nuk e njeh shtetin palestinez. Izraeli e ka nisur fushatën

ushtarake në Gazë në përgjigje të sulmit të kryer nga Hamas në jug të Izraelit më 7 tetor 2023, si pasojë e të cilit janë vrarë 1.200 njerëz dhe janë marrë peng rreth 240 të tjerë. Sipas autoriteteve shëndetësore palestineze, mbi 59.000 palestinezë janë vrarë në Gazë prej atëherë. Pjesa më e madhe e Gazës tani është shndërruar në gërmadhë. Agjencia e OKB-së për Refugjatë Palestinezë (UNRWA) ka thënë se një në pesë fëmijë në qytetin e Gazës tani është i kequshqyer dhe që numri i rasteve po rritet çdo ditë. Mbi 100 organizata ndërkombëtare të ndihmës dhe grupe për të drejta të njeriut kanë paralajmëruar për uri masive në Rripin e Gazës, duke iu bërë presion qeverive në botë që të veprojnë. Izraeli, i cili kontrollon hyrjen e të gjitha furnizimeve në Gazë, përsërit se nuk ka rrethim dhe e fajëson Hamasin për çdo rast të kequshqyerjes.

Arabia Saudite nënshkruan marrëveshje për rindërtimin e Sirisë

RIADI, 25 KORRIK - Arabia Saudite nënshkroi marrëveshje të rëndësishme investimi dhe partneriteti me Sirinë, me vlerë prej 6.4 miliardë dollarësh, për të ndihmuar në rindërtimin e infrastrukturës, telekomunikacionit dhe sektorëve kryesorë të tjerë të vendit të shkatërruar nga lufta. Mbretëria e pasur me naftë në Gjirin Persik është një nga mbështetëset kryesore të Qeverisë e re siriane, e cila mori

pushtetin pas një ofensive të udhëhequr nga islamistët që rrëzoi nga pushteti udhëheqësin e komtshëm të Sirisë, Bashar al-Assad, në dhjetor. Duke folur në Forumit të Investimeve Siri-Arabi Saudite të mbajtur në pallatin presidencial në Damask, ministri saudit i Investimeve, Khalid Al-Falih, njoftoi për “nënshkrimin e 47 marrëveshjeve dhe memorandumeve mirëkuptimi... me një vlerë totale prej gati 6.4

miliardë dollarëve”. Me praninë e presidentit të përkohshëm sirian, Ahmed al-Sharaa, dhe zyrtarëve të tjerë, ministri sirian i Ekonomisë, Mohammed al-Shaar, e quajti këtë forum “një hap të madh në historinë e marrëdhënieve midis dy vendeve tona vëllazërore”. Falih tha se 2.9 miliardë dollarë do të dedikohen për infrastrukturë dhe do të ndërtohen tri fabrika të çimentos.



Haradinaj: Ende kemi shumë për të bërë në avancimin e pozitës së gruas në shoqërinë tonë

PRISHTINË, 25 KORRIK - Në kuadër të programit “Ditët e Partisë”, organizuar nga NDI nën ombrellën e Javës së Gruas 2025, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka marrë

pjesë së bashku me koleget nga Aleanca e Gruas, me të cilat ka ndarë të njëjtin vizion dhe përkushtim për barazi të plotë gjinore në politikë dhe shoqëri. “Ende kemi shumë

për të bërë për avancimin e pozitës së gruas në shoqërinë tonë, për barazi në përfaqësim dhe në vendimmarrje. E ritheksova angazhimin tim të palëkundur se do të jem

gjithmonë zë i fuqishëm dhe luftëtar i së drejtës së gruas në jetën publike, politike dhe institucionale. Barazia nuk është vetëm kauzë, është detyrë”, ka thënë Haradinaj.



NGRIHEN SHQETËSIME LIDHUR ME SITUATËN FINANCIARE NË RTK

PRISHTINË, 25 KORRIK - Organizatat që merren me të drejtat e gazetarëve, por edhe institucione të tjera ndërkombëtare, kanë ngritur alarmin lidhur me situatën financiare me të cilën po përballlet transmetuesi i vetëm publik në Kosovë, Radio Televizioni i Kosovës (RTK). Punëtorët e RTK-së rrezikojnë të mbesin pa paga për muajin korrik dhe vetë puna e këtij institucioni rrezikohet për shkak të moskonsituimit të Kuvendit të Kosovës dhe mungesës së themelimit të Komisionit Parlamentar për Buxhet, ka paralajmëruar transmetuesi. Drejtori i përgjithshëm i RTK-së, Hysen Hundozi, tha ditë më parë se po vazhdojnë përpjekjet për të gjetur një zgjidhje lidhur me alokimin e gjysmës së dytë të buxhetit të RTK-së, i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës. “Transmetuesi publik duhet të mbetet i pavarur dhe të funksionojë pa ndërprerje - edhe në kohë krizash politike e institucionale”, tha ai pas një takimi me Avokatin e Popullit, Naim Qelaj. Lidhur me situatën financiare të RTK-së më 24 korrik ka reaguar edhe Bashkimi Evropian. Blloku evropian u ka bërë thirrje autoriteteve kompetente të sigurojnë financim të qëndrueshëm dhe afatgjatë për RTK-në si dhe të mundësojnë funksionimin e papenguar të transmetuesit publik. “Ne mbetemi të shqetësuar për vonesat e vazhdueshme të cilat tashmë kanë pasoja konkrete”, tha BE-ja. Shqetësim për situatën financiare të RTK-së ka shprehur edhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës. “AGK-ja e njuh rolin e rëndësishëm që luan transmetuesi publik në skenën mediale të Kosovës, dhe në mungesë të Kuvendit funksional i bën thirrje Qeverisë



së Kosovës, që të ndërmarrë hapat e nevojshëm për vazhdimin e financimit të RTK-së”, u tha në reagimin e AGK-së. Për gjendjen e krijuar në RTK si pasojë e ngërçit politik kanë reaguar edhe organizatat ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e gazetarëve. Unioni Evropian i Transmetimeve (EBU), që është aleanca më e madhe në botë e transmetuesve publikë dhe që përfaqëson mbi 100 transmetues në më shumë se 56 vende, përmes një letre drejtuar institucioneve të Kosovës shprehu shqetësim për situatën e krijuar. “E kuptojmë se konteksti politik aktual kufizon aftësinë e Kuvendit për të vepruar. Në këtë kuptim, RTK i është drejtuar zyrtarisht

Qeverisë suaj, përfshirë Ministrinë e Financave, për ndërhyrje të menjëhershme institucionale dhe alokim të fondeve të nevojshme. Vendimi i Qeverisë për ta bërë këtë nuk do të krijonte precedent, pasi raste të ngjashme janë hasur në të kaluarën në rrethana të krahaseshme”, u tha në letrën e EBU-së. Sipas EBU-së, nëse nuk veprohet nga 1 korriku RTK do të mbetet pa pjesën e dytë të buxhetit të saj vjetor për shkak të moskonstituimit të Kuvendit. Ky union tha, po ashtu, se nëse RTK-ja nuk merr fondet e miratuara, transmetuesi nuk do të arrijë t’i përmbushë detyrimet ligjore dhe financiare. “Kjo do të rezultonte në ndërprerjen e parë ndonjëherë të shërbimit për

transmetuesin e vetëm publik në Kosovë. Një gjë e tillë do të kishte pasoja serioze për lirinë e medias, mbikëqyrjen demokratike dhe të drejtën e publikut për informacion të saktë dhe të pavarur. Kjo krizë është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me detyrimet ligjore të Kosovës dhe standardet evropiane”, tha EBU-ja. Federata Evropiane e Gazetarëve tha se i bashkohet shqetësimit të ngritur nga AGK-ja lidhur me problemet financiare me të cilat përballlet RTK-ja. “Për muaj të tërë RTK-ja është përballur me krizë të thellë financiare si rezultat i dështimit të qëllimshëm nga institucionet e Kosovës për të alokuar buxhetin e miratuar.

Paralajmërimi se RTK-ja mund të mbetet pa mjete financiare brenda pak ditësh dhe që të mos jetë në gjendje të paguajë punëtorët për muajin korrik është shqetësues”, tha kjo federatë. Drejtoresha e Federatës Evropiane të Gazetarëve, Maja Sever, tha po ashtu se shpreson që autoritetet e Kosovës do të ndërmarrin masa urgjente që të lejojnë punën e transmetuesit publik, në linjë me standardet evropiane “që kërkojnë garanci për financim afatgjatë, qeverisje të qëndrueshme dhe kushte të denja pune”. Teksa kriza financiare me të cilën po përballlet RTK-ja po vazhdon, deputetët kanë dështuar për herë të 52-të që ta konstitujnë Kuvendin.

Uji i pishinës së Gërmisë është në përputhje me standardet

PRISHTINË, 25 KORRIK - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës nëpërmjet një njoftimi për medie ka njoftuar të premtën se rezultatet e mostrave të ujit të pishinës së Gërmisë të marra më 23 korrik kanë rezultuar brenda

rezultateve të parapara sipas rregullores për pishina Megjithatë, IKShPK-ja po vazhdon monitorimin e cilësisë së ujit në pishinën e Gërmisë. “Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), në kuadër të

mandatit të tij për mbrojtjen e shëndetit publik, vazhdon me monitorimin e cilësisë së ujit në pishinën e Gërmisë. Rezultatet e mostrave të ujit të pishinës së Gërmisë të marra me datë 23 korrik 2025 rezultojnë brenda standardeve të parapara sipas

rregullores për pishina. Me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik, ekipet e departamentit të Ekologjisë Humane/IKShPK do të vazhdojnë me monitorimin e ujit për pije dhe ujit në pishinën e Gërmisë”, ka njoftuar IKShPK-ja.





DËSHTON SËRISH KONSTITUIMI I KUVENDIT TË KOSOVËS

AMBASADORËT E HUAJ TË ZHGËNJYER PËR MOSKONSTITUIMIN E KUVENDIT

Deputetët kanë dështuar edhe të premten ta konstitujnë Kuvendin, një ditë para skadimit të afatit 30-ditor të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese për finalizim të procesit. Seanca e radhës do të mbahet sot në orën 14:00. Më 24 korrik Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim për masë të përkohshme përmes të cilit ua ndalon deputetëve çdo veprim në drejtim të konstituimit të Kuvendit në periudhën 27 korrik - 8 gusht. Në seancën e 52-të konstituive të pranishëm ishin edhe e ngarkuara me punë e ambasadorit të ShBA-së, ambasadori i Gjermanisë, i Britanisë së Madhe dhe i Francës, të cilët bënë thirrje për konstituimin e Kuvendit, duke theksuar se Kosova po hyn në territor të panjohur

Mal QORRAJ

Prishtinë, 25 korrik - Kryesuesi i seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës, Avni Dehari, ka ftuar seancën e radhës, të 53-tën, për të shtunën, në orën 14:00. Thirrja për seancën e radhës u bë pasi me vetëm 54 vota për formimin e komisionit për votim të fshehtë, sërisht dështoi të premten konstituimi i Kuvendit. Seanca e radhës do të mbahet vetëm një ditë para se të hyjë në fuqi masa e përkohshme e Gjykatës Kushtetuese për të mos lejuar

asnjë veprim nga deputetët për konstituim të Kuvendit nga 27 korriku deri më 8 gusht. Ambasadori i BE-së në Kosovë, Aivo Orav, u shpreh i zhgënjyer që deputetët e dalë nga zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit nuk arritën sërisht ta bëjnë konstituimin e Kuvendit të Kosovës. “Kosovës i duhet një Kuvend pak a shumë menjëherë. Kosovës i duhet një qeveri e re, një qeveri e re që do ta ndërtojë urën e re - një urë të re dhe të fortë mes Kosovës dhe Brukselit”, tha Orav në hollin e Kuvendit pas mbylljes së seancës konstituive.

Ai shtoi se ndërtimi i një bashkëpunimi të tillë do ta përshpejtonte procesin e anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian. Në seancën e 52-të konstituive ai ishte i pranishëm bashkë me përfaqësues të tjerë ndërkombëtarë nga ShBA-ja, Gjermania, Britania e Madhe, Franca etj. “Ne erdhëm këtu me shpresa të mëdha por, fatkeqësisht, prapë nuk ndodhi asgjë”, tha Orav. Edhe ambasadori britanik në Kosovë, Jonathan Hargreaves, u ka bërë thirrje politikanëve të Kosovës që të bashkohen dhe të gjejnë një zgjidhje për t'i dhënë fund bllokadës para se të nisë zbatimin e masës së përkohshme të Gjykatës Kushtetuese. “Përndryshe, Kosova po hyn në territor të panjohur dhe shtetasit e saj vazhdojnë ta humbin përfaqësimin politik kuptimplotë dhe aftësinë për të marrë vendime të rëndësishme vendase dhe ndërkombëtare që ndikojnë në jetën e qytetarëve”, ka thënë ambasadori në “Facebook” pas pjesëmarrjes në përpjekjen e 52-të të deputetëve për konstituim të Kuvendit. Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, e quajti fatkeqësi dështimin e serishëm të

deputetëve për ta konstituuar Kuvendin e Kosovës. Duke folur në hollin e Kuvendit pak pas mbylljes së seancës, ai tha se “jemi këtu për ta theksuar shqetësimin tonë dhe urgjencën për t'i formuar institucionet”. “Qytetarët dolën për të votuar më 9 shkurt dhe tani janë bërë gati gjashtë muaj. Klasa politike po dështon përballë qytetarëve”, tha Rohde. Ai e quajti vendimin e djeshëm të Gjykatës Kushtetuese për të vendosur masë të përkohshme si karton të kuq “sepse po e suspendon parlamentin për të marrë një vendim”. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë se partia të cilën e drejton ai nuk e ka kërkuar masën që e ka caktuar Gjykata Kushtetuese, megjithatë ky institucion është në drejtën e vet. “Besoj se ka një arsye të cilën nuk mund ta paragjykoj. Cila mund të jetë arsyeja ndoshta është diçka që do ta kuptojmë kur të publikohet aktgjykimi”, ka thënë Krasniqi, duke thënë se PDK-ja do ta respektojë vendimin. I pyetur nëse partia e tij është e gatshme për zgjedhje të parakohshme, ai ka thënë se në rrethanat aktuale nuk do të ishte diçka e jashtëzakonshme,

ndonëse do të jetë diçka e mundimshme, pasi afër janë edhe zgjedhjet lokale të 12 tetorit. “Në fund të fundit, demokracia funksionon kështu”. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka përsëritur sërisht se kryesuesi i seancës, Avni Dehari nga Lëvizja Vetëvendosje, e ka shkelur Kushtetutën. Edhe ai ka thënë se partia e tij do të jetë në pritje të aktgjykimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese. “Kryesuesi e ka shkelur Kushtetutën. Kjo është përmbyseje e rendit kushtetues. Tani presim që të ketë edhe vendim përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese për lëndën tonë”, ka deklaruar Abdixhiku pas dështimit të 52-të për konstituim të Kuvendit. Sipas LDK-së dhe partive të tjera të mëdha shqiptare, Dehari po vepron në mënyrë jokushtetuese, duke insistuar në formimin e një komisioni për votim të fshehtë. Kreu i Aleancës së Ardhmërisë për Kosovën (AAK), Ramush Haradinaj, tha se ai e sheh si shenjë të mirë që Gjykata Kushtetuese ka vendosur një masë të përkohshme që të mos ndërmerret asnjë vendim për konstituimin e Kuvendit nga 27 korriku deri më 8 gusht. “Është e mundshme që gjykata e ka

SHBA-ja SHEH MUNDËSI PËR BASHKËPUNIM EKONOMIK ME KOSOVËN, KËRKON HEQJEN E BARRIERAVE

PRISHTINË, 25 KORRIK - Shtetet e Bashkuara vlerësojnë për “Radion Evropa e Lirë” se ekzistojnë mundësi të rëndësishme për bashkëpunim ekonomik me Kosovën në disa sektorë strategjikë dhe se heqja e barrierave tregtare do t'i forconte më tej këto lidhje. “Shohim mundësi për bashkëpunim ekonomik në Kosovë në disa sektorë, përfshirë energjinë, mbrojtjen, infrastrukturën, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, si dhe sigurinë kibernetike. Heqja e barrierave ndaj eksporteve amerikane do të rezultonte me rritje të tregtisë”, tha një zëdhënës i Ambasadës amerikane në Prishtinë për “REL”-in. “Ne i inkurajojmë sektorët publikë dhe privatë në Kosovë që të vazhdojnë të kërkojnë mundësi ekonomike dhe investime në tregun amerikan dhe që Qeveria të promovojë një mjedis transparent dhe të qëndrueshëm për bizneset amerikane që kërkojnë të zgjerohen në Kosovë”, tha ai. Ky qëndrim përkon edhe me përpjekjet e Kosovës për ta zgjeruar bashkëpunimin ekonomik me ShBA-në, sidomos pas vizitës së presidentes Vjosa Osmani në Uashington këtë muaj. Gjatë takimeve me zyrtarë të lartë amerikanë, përfshirë zëvendëssekretarin e Shtetit, Christopher Landau, ajo tha se u fol për rëndësinë e krijimit të një partneriteti të ri ekonomik, me



fokus në sektorin e energjisë, të mbrojtjes dhe të teknologjisë informative. “Radio Evropa e Lirë” mori vesh se temë diskutimi ishte edhe mundësia e bashkëpunimit në sektorin e pasurive minerare. Ekspertët e ekonomisë e përkrahën këtë vizion, duke nënvizuar se pozicioni gjeografik, fuqia e re dhe e

arsimuar e punës, si dhe politikat fiskale konkurruese, e bëjnë Kosovën një destinacion tërheqës për investitorët e huaj. Megjithatë, ata theksuan nevojën për reforma të thella në sundimin e ligjit dhe politikat ekonomike. “Kosova duhet të angazhohet më tej në forcimin e sundimit të ligjit, në shmangien e veprimeve që mund të rrisin

paparashikueshmërinë juridike, si dhe në rritjen e mbrojtjes së investitorëve, përmes përmirësimit të efikasitetit të gjykatave”, i tha “Radios Evropa e Lirë” më 18 korrik Arian Zeka, kryetar i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë. Kosova, aktualisht, ka një taksë prej 10 % për mallrat e importuara nga ShBA-ja.

Në fillim të prillit presidentja Osmani kërkoi nga Qeveria e Kosovës pezullimin e saj, pas vendimit të presidentit amerikan Donald Trump për tarifë të ngjashme ndaj importeve nga Kosova, por taksa mbeti në fuqi. Osmani tha, po ashtu, se zyra e saj ka përgatitur një projektligj për heqjen e taksës, por se miratimi i tij varet nga konstituimi i Kuvendit të ri. Konstituimi nuk ka përfunduar ende për shkak të mosmarrëveshjeve politike qysh pas zgjedhjeve të shkurtit. Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, vlera e importeve nga ShBA-ja në vitin 2024 ka arritur mbi 105 milionë euro, ndërsa eksportet kanë qenë rreth 39 milionë euro. Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve njofton se investimet amerikane në Kosovë gjatë vitit 2024 kapën vlerën prej rreth 87 milionë eurosh. Zëdhënësi i Ambasadës amerikane në Prishtinë theksoi se stabiliteti dhe siguria në rajon janë kyçe për prosperitetin ekonomik. Duke cituar zëvendëssekretarin e Shtetit, Christopher Landau, ai shtoi: “Misionet tona në mbarë botën janë gati të ndihmojnë bizneset dhe investitorët e huaj që të bashkëpunojnë me partnerët tanë amerikanë nga sektori publik dhe privat, për të shfrytëzuar kompanitë tona kryesore, teknologjinë dhe fuqinë punëtore”.

paraparë që kaq kohë i duhet për një vendim. Pra i bie që jemi në një periudhë më dinamike”, tha Haradinaj para seancës së 52-të konstitutive. Më tutje, ai tha se partia e tij është e gatshme për zgjedhje, por se ato i sheh si opsion i fundit. “Ne nuk mendojmë se duhet të favorizohen zgjedhjet pa i shteruar mundësitë për t'i krijuar institucionet”, tha Haradinaj. Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë pas seancës se partia e tij nuk shkon drejt zgjidhjeve parciale dhe nuk kontribuon që vendi të shkojë në zgjedhje. “Kur Nisma të jetë e sigurt se po formohet një shumicë qeveritare, do ta japë kontributin e vet që vendi të mos shkojë në zgjedhje të parakohshme”. “Shumicë qeveritare nuk ka zgjidhje parciale. Është bërë temë zgjedhja e kryetarit të Kuvendit, por për mua s'ka qenë asnjëherë temë zgjedhja e kryetarit të Kuvendit. Fondamenti i kësaj krize është mospasja e numrave të nevojshëm për qeveri, dhe derisa nuk ka numra të mjaftueshëm për qeverisje, gjërat kanë ngelur ku janë sot”, tha ai. Mes të tjerash, Limaj tha se në

interes të demokracisë dhe funksionimit të institucioneve, “do të ishte mirë ta presim aktgjykimin, më pas forcat politike të mobilizohen e t'i themelojnë institucionet”. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Hekuran Murati, ua ka atribuuar partive të tjera politike dështimin për konstituim të Kuvendit, duke e quajtur “jokushtetutes” vendimin e tyre për të mos propozuar nga një deputet për komision për votim të fshehtë. “Sa i përket rrugës përpara, ne e kemi edhe nesër një mundësi. Është dita e fundit, sipas afatit të caktuar nga Gjykata Kushtetuese. Nuk mendoj se ka nevojë të pritë masa e përkohshme, sepse atëherë hyjmë në territor të pashkelur më parë sa iu përket veprimeve dhe pasojave, pas tejkalimit të këtij afati. U bëj thirrje të gjithë deputetëve që ta shfrytëzojnë mundësinë, të votohet komisioni i fshehtë, të marrin pjesë, qoftë për, kundër apo abstenim, pavarësisht votës së tyre, le ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre kushtetuese”. Ai e ka përmendur edhe një herë zotimin e LV-së që nëse Albulena Haxhiu nuk i merr votat e

Kushtetuesja ndalon mbajtjen e seancës konstitutive të Kuvendit pas afatit 30-ditor

Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka vendosur masë të përkohshme, që do të jetë në fuqi nga 27 korriku deri më 8 gusht, periudhë në të cilën deputetëve u ndalohet të ndërmarrin çdo vendim apo veprim për konstituimin e Kuvendit të dalë nga zgjedhjet e shkurtit. Në arsyetim, Gjykata tha se nëse nuk do të vendosej masa e përkohshme ex officio ndaj vendimeve dhe veprimeve të deputetëve të zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës pas datës 26 korrik 2025, çdo vendim dhe veprim i ndërmarrë pas kësaj date deri në

vendimmarrjen e Gjykatës lidhur me kërkesat “mund të shkaktojë dëme të pariparueshme për rendin kushtetues të Republikës së Kosovës dhe funksionimin e institucioneve kyçe në Republikën e Kosovës”. Më 24 korrik Kushtetuesja tha se ekzistojnë rrethana të interesit publik, që e përfshijnë rendin kushtetues të Kosovës, që ndërlidhen me themelimin e institucioneve shtetërore pas zgjedhjeve për Kuvend. “Prandaj, ndalimi i çdo vendimi dhe veprimi nga ana e deputetëve të zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës pas 26 korrikut 2025 është në interes

publik, i domosdoshëm për ruajtjen e rendit kushtetues dhe interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj”, u tha në vendim. Vendimi për vendosjen ex officio të masës së përkohshme, Kushtetuesja tha se e mori pas pranimit të dy lëndëve në fillim të korrikut nga Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Këto dy lëndë janë bashkuar, tha Kushtetuesja, duke shtuar se Gjykata, po ashtu, ka pranuar komente nga Lëvizja Vetëvendosje lidhur me këto lëndë.

nevojshme për t'u zgjedhur kryeparlamentare edhe në votim të fshehtë, atëherë ajo do të tërhiqet. Murati ka insistuar sërish se veprimet e partisë së cilës i takon

janë krejtësisht kushtetuese. Kryetarja e Partisë së Re Demokratike, Emilija Rexhepi, si një nga përfaqësuesit e komunitetit boshnjak në Kuvendin e Kosovës, tha se nuk

pret të ketë marrëveshje mes Lëvizjes Vetëvendosje dhe Nismës Socialdemokrate për konstituim të Kuvendit sot. “Sa unë e di, ata flasin vetëm për koalicion për qeveri”, tha Rexhepi.



BISEDË PËRMES HEKURASH ME ISH-PRESIDENTIN HASHIM THAÇI

THAÇI: UNË SOT JAM I PRIVUAR PËRKOHËSISHT, POR POPULLI IM ËSHTË I LIRË PËRJETËSISHT

“Ky është çmimi i përballjes së mëhershme me tiraninë. Unë sot jam i privuar për kohësisht, por populli im është i lirë përjetësisht”

PRISHTINË, 25 KORRIK-

Adriatik Kelmendi: Pak kohë më parë ju humbët babanë. Sa ju ka pikëlluar vdekja e tij?

Hashim Thaçi: Zhvillimet rreth pyetjes suaj kanë një parahistori, në korrik të vitit 2023 me lejen e DHSK-së në vendlindje vizitova prindërit i gjeta në gjendje jo të mirë shëndetësore u preka shumë. Kuptova se pleqëria dhe mërzia kishin bërë punën e vet në shëndetin e tyre fizik, por jo moral. Në këto rrethana të rënda, edhe pse fjalëpakë, tek ata përsëri gjeta humorin e lehtë dhe të këndshëm. Gjithherë jam munduar të mos i shqetësoj, por e di se janë mërziur shpesh nga shqetësimi për mua. Ata nuk kishin frikë, por si çdo prind për djalë apo vajzë, gjithmonë ka

drojën, kam parasysh edhe rrethanat e rrezikshme që kemi kaluar si popull.

Në pak orë qëndrimi më ringjiznin vlerat e tyre shpirtërore, solidariteti dhe humanizmi, dinjteti, shija për gjëra të mira. Ata kanë sakrifikuar shumë duke rritur tetë fëmijë në rrethana dhe hapësirë jo të lehtë sociale dhe gjeografike, por duke i dhënë kuptim jetës përmes punës, një vullnet i pathyeshëm për t'i edukuar fëmijët. Shembull i mirë për mjedisin shoqëror të asaj kohe.

Prindërit më mishëruan ABC-në e dashurisë për truallin ku kam lindur, familjen, fqinjin, atdheun dhe lirinë. Lidhjen e ngushtë me prindërit e kam ruajtur të pacenueshme në çdo kohë dhe rrethanë të jetës, si fëmijë, nxënës, student, djalë i

diasporës, luftëtar lirie apo edhe si politikan dhe tash si i privuar nga liria. Jam munduar të mos i lëndo, por edhe nëse e kam bërë ndonjëherë, jam penduar shpejt. Kjo ka ndodhur kur isha fëmijë. Por sa më shumë ecën koha po kuptoj se sa pak kohë u kushtojmë prindërve kur zhytemi në vorbullën gëlltitëse të zhvillimeve ditore, ndonjëherë edhe të padobishme.

Tani mendoj për kohën më shumë që ata do të donin të kalojnë me fëmijët që i lindën dhe i rritën, e tash edhe mbesave e nipërve. Prindërve ua kam borxh jetën. Ju përulëm për të gjitha. Më dhanë besim për jetën dhe mundësinë për të ecur pa u ndalur. I dhanë kuptim dhe karakter jetës sime etike dhe profesionale. Më jepnin buzëqeshjen e tyre të

bukur, që mua më lumturonte dhe energjizonte. Por babai dinte edhe të zemërohej. Ruaj në kujtesë ndëshkimin e tij kur vonohesha duke tejzgatur lojën e futbollit me shokët e shkollës deri në errësirë, duke u kthyer i përbaltur në shtëpi. Ndëshkimi ishte të qëndroja për një kohë në oborr. Kjo masë vazhdonte derisa ndërhynte nëna e cila me urtësinë e saj e bindte babanë të hiqte dorë nga ndëshkimi. Prindërit më kanë rritur sigurinë në gjërat që kam bërë gjatë jetës.

Ruaj të freskëta me dhimbje dhe forcë gjestet e nënës dhe babait, duart e ngrohta të tyre, përqafimin e përmallshëm. Gjatë kësaj vizite vëreja më shumë rrudha në ballin e tyre, por kujtesë dhe kthjelltësi mendore të mirë. Kur u përshëndetëm dinjitetshëm më

thanë rruga e mbarë dhe mirupafshim, me zemër të lënduar, pa lot në sy, por thellë - mendueshëm. Sido që të jetë, shpirti dhe zemragur e tyre e dinë.

Po atë mbrëmje u ktheva në Hagë.

Një kohë kur isha nxënës kisha kuptuar pse babai me gjithë ofertën nga disa të afërm dhe miq kishte sfiduar mundësinë në vitet tetëdhjetë për të mërguar si gastarbajter në Gjermani apo Austri, me arsyetimin se “ishte i vetëm në shtëpi, duhej ta punonte tokën të mos mbesë djerrinë dhe të qëndronte afër fëmijëve”. Kam bindjen, se arsye e vetme ishte prindërit nuk mund të rrinin pa njëri-tjetrin, ndërsa bashkimi familjar në Perëndim atë kohë pothuajse ishte tabu për punëtorët jashtë vendi. Kam

parasysh edhe moshën e thyer të gjyshit dhe gjyshes për të cilët edhe realisht duhej të kujdesej.

Babai më thoshte: “Je hy në punë të rënda... sa për Serbinë mos u mërzit, veç me shokë mos u korit”

Gjatë vitit 2024, edhe pse në gjendje aspak të mirë shëndetësore, prindërit më vizituan për herë të dytë në hapësirat e qendrës së paraburgimit. Ishte rrethanë mallëngjyese. Kaluan tri orë sikur të ishin tre minuta. Mbetëm të etur për t’i vazhduar muhabetet. Edhe pse të lodhur nga mosha për të pritur mysafirë, tregonin falënderim, mirënjohje për solidaritetin e shumë njerëzve me vizitat e tyre në Burojë. Që ta relaksoja më shumë ndejën, ju kujtoja kujdesin që tregonin për mua kur isha nxënës dhe udhëtoja me autobus çdo ditë nga Buroja në Skenderaj, më jepnin para çdo ditë për byrek, çaj dhe për blerjen gazetës “Rilindja”. Unë më tepër lexoja faqet sportive, rubrikën e kulturës dhe ndonjë fejtון historik që ia vlente. Me prisnin në mbrëmje për darkë. Kujdeseshin në imtësi për higjienën dhe veshmbathjen. Më kursenin nga punët e shtëpisë. Ia freskova babait kujtesën për një bisedë që kishim zhvilluar në një nga pranverat e fillim viteve nëntëdhjetë, tanimë student, gjatë një fundjave në kopshtin e shtëpisë, duke i ndihmuar në mirëmbajtjen e oborrit - kositjen e barit në një moment pushimi nën hijen e një qershie kur ishim vetëm për vetëm më tha: “E di dhe po e shoh se je hy në punë të rënda”, vazhdoi “diçka dua të të them, sa për Serbinë mos u mërzit, veç me shokë mos u korit”. Ai i njihte, i priste në shtëpi, i respektonte, i donte shumë, me shumicën prej tyre ishte bërë edhe bashkëluftëtar (në kohën kur fasulja hahej me nga një kokërr). Pas luftës ata që kishin rënë në altarin e lirisë i kujtonte dhe evokonte kujtimet për të bërät e tyre heroike në bashkëbisedime me njerëzit, ndërsa me ata që mbetën gjallë ruajtj gjithmonë respektin për sakrificën dhe raportin njerëzor shumë të afërt personal deri në çastet e fundit të jetës. Ndiheh çdoherë i nderuar nga ai raport i veçantë i babait me shokët e mi. Në Burojë ai kishte pritur dhe përcjellë shumë prej tyre në kohë dhe rrethana të paharruara. I kishte kaluar i pacenueshëm edhe bastisjet në fshat dhe arrestimin që ia kishin bërë në vitet 1993 dhe 1997. Këshillat e tij më kanë përcjellë gjithmonë, më janë përputhur jo rrallë me realitetin e përvojës sime jetësore. Prindërit nuk e kanë pëlqyer jetën e të rënit në sy apo të veçuar, megjithëse pa dëshirën e tyre dhe pahetueshëm kjo ndodhi. Nuk

ishin nga ata që pëlqenin politikën, por e përcillnin. Gjatë kësaj vizite i pyeta sa për ta provokuar bisedën se pse nuk vinin në më shumë ngjarje publike dhe politike. Babai më tha: “Ti duhet të jesh vetja jote”. Njëherë më ka vizituar në zyrën e punës në selinë e Partisë Demokratike të Kosovës.

“Po me dhimesh se ke me hjek shumë, ishalla ke edhe njerëz të mirë rreth vetes”

E kujtoj bisedën me prindër pas zgjedhjeve lokale në nëntor 2000 kur të dy, si duke plotësuar njëri-tjetrin, sikur donin të më ngushëllonin për humbjen më thanë: “Nuk është fundi i botës, jeta është e gjatë, i ri je, ruaje shëndetin, veç rri drejt, zoti të ndihmoftë”. Babai qeshte me zë kur i përmendja bisedën në mëngjesin e parë të pasfitores zgjedhore parlamentare dhe lokale të nëntorit 2007, kur i emocionuar dhe i gëzuar, por shumë seriozisht, më tha: “Po me dhimesh se ke me hjek shumë, ishalla ke edhe njerëz të mirë rreth vetes, edhe kalon mirë me qita që kanë ardhë prej botës këtu”. Me babanë kisha thyer konfidencialitetin e mosbërjes publike të ditës së shpalljes së pavarësisë së Kosovës, vetëm tri apo katër ditë përpara të dielës së 17 shkurtit të vitit 2008. Gjatë bisedës telefonike të rregullt ditore të mëngjesit më pyeti “kur po kryhet qikjo puna e madhe?”, i thashë “me kismet të dielën pasdite”. Nuk kisha bërë asgjë të gabuar. Ai ishte bashkëluftëtari im nga orët e para. E dija se nuk do të fliste me askënd. Prindërit ishin të parët që më uruan në telefon pak çaste pas shpalljes së pavarësisë: “Përhajr dhe e gëzofshim!”. Gjatë fushatës për mandatin e tretë, më 2014, prindërit, Lumja dhe Endriti, do të bëheshin pjesë aktive dhe e rëndësishme e pjesëmarrjes në fushatë. Ata do të merrnin pjesë në tubime, do të flisnin në medie. Ishte hera e parë që në Kosovë prindërit e ndonjë lideri shfaqeshin në publik me mesazhe mbështetëse për birin e tyre. Fjalët që kishin zgjedhur dhe mënyra si ishin paraqitur kishte fituar një pëlqyeshmëri e respektuar në opinionin publik. Kishin folur për karakterin tim që buronte nga ADN-ja e tyre. Prindër të thjeshtë dhe origjinalë. Fitorja ishte spektakulare, e gjashta me radhë. Shpesh u thosha “këtë fitore jua dedikoj juve”. Do të jenë të paharrueshme mbresa dhe emocionet që shihja në shpirtin dhe fytyrën e tyre në rastin e inaugurimit tim president në sheshin “Nena Tereza” në prill 2016. E lexoja dhe ndieja krenarinë e tyre për birin e tyre.



Ta kemi parasysh, nuk është e lehtë të jesh prind, bashkëshort apo fëmijë i politikanit në hapësirat tona. Përpos fjalëve dhe ditëve të mira, duhet të durosh gjëra dhe ditë të paimagjinueshme negative - atakuese kundër suksesit. Nuk kishte ndodhur më parë që prindërit e një djali a vajze në vendin tonë merrnin pjesë në ceremoninë më të lartë shtetërore. Pikërisht në sheshin simbol të protestave antijugosllave, tani simbol i paqes në Kosovën - shtet. Ndihesha shumë krenar me ta dhe me praninë e tyre. Ata dinjitetshëm pranuan me shtrëngim duarsh urimet e diplomatëve dhe pjesëmarrësve vendorë në përmbyllje të ceremonisë. Morën pjesë edhe në drekën e shtruar enkas për mysafirë nga Presidenca. Duke u ndarë në fund të kësaj vizite si me një zë më thanë: “Po jetojmë duke të pritur”. E dija se kjo rrethanë ishte bërë barrë e rëndë për moshën e tyre... Mungesa ime i kishte goditur shumë. Nga kjo vizitë e kuptova se tani e tutje çdo takim ose bisedë telefonike mund të jetë e fundit. Tutje tregova, edhe më shumë i kujdeseshëm, për orarin që duhej thirrur dhe shfrytëzimin maksimal të kohës për të

biseduar sa ma shpesh me ta. Në bashkëbisedim me prindër, shpirti dhe mendja më fluturonin gjithmonë drejt vendlindjes, lojërave rinore, fushave, kodrinave që lidhen me kuptimin e fëmijërisë sime. Edhe pse shpesh në distancë me njëri-tjetrin, gjithmonë marrëzisht kam qenë me ta dhe i tyre.

Adriatik Kelmendi: *Megjithatë, ju e vizituat babanë në spital dhe biseduat me të vetëm disa ditë para vdekjes. Çfarë biseduat bashkërisht, dhe si u ndjetë të flisnit me babanë në rrethana të tilla, duke e ditur se mund edhe mos ta takoni më kurrë?*

Hashim Thaçi: Në ditët e para të janarit të këtij viti nga familjarët u informova se gjendja e babait ishte përkeqësuar. Bisedat telefonike apo ato përmes videolidhjes u rralluan nga pamundësia e tij për t’u përgjigjur. Edhe kur flisja shkurt nuk ishte më zëri i tij. Edhe në pamje kishte filluar të ndryshonte, por përpiquej të mos jepej. E kuptoja, nuk doja të besoja. Ishte nisur në rrugëtimin e botës së përtejme. Po bëheshin tre muaj që babai ishte sëmurë rëndë. Paneli i gjyqtarëve pas një kohe aprovoi lejen për një vizitë disaorëshe në Kosovë.

I shoqëruar nga oficerët e DHSK-së dërgohem në Kosovë. Në Prishtinë po kthehesha pas katër vjet e gjysmë. Duke zbritur nga drejtimi i Vetrenikut, afrohem afër hapësirës ku valëvitet flamuri kombëtar. Nga shirat dhe ndotjet dukej i qulllosur, i fjetur; mezi rrinte i varur në shtyllë metalike. Shqiponja e ndarë në pjesë që vështirë ishte të ringjiteshin. Trafiku, si gjithmonë i ngarkuar, lëvizjet e njerëzve shumë dinamike, kafe-baret plot e përplot gjallëri. Tanimë ishte mesditë, koha me diell. Ishte bërë publik lajmi për rikthimin tim. Disa qytetarë me familjarë të tyre kishin dalë në ballkonet e banesave dhe regjistronin me telefonat e tyre lëvizjen e eskortës që më bartte. Ishim jo larg njëri-tjetrit. Unë i shihja, ata nuk mund të shihnin, se na ndante xhami i errësuar i makinës. Mendoj se kishim të njëjtin sentiment. Kaloj përreth hapësirës ku më herët ishte vendosur vënia e shtatores së Adem Demaçit. Nuk kishte risi, nuk u befasova. E kuptoja arsyen e paarsyeshme të mosvënies ende, thashë me vete. “Liria e Kosovës është monument i Adem Demaçit”. Prandaj, nuk ka bust, lapidar apo shtatore që e zëvendëson lirinë e një populli. Kështu e



përjetova hyrjen në Prishtinë. Po kthehesha më i thinjur, por kisha ndjesinë se Kosova disi ishte e lodhur dhe e molisur. Edhe pse nuk jam nga ata që nga mosprezenca në mjedis, të ndikohem që gjërat t’i shoh bardhezi. Përkundrazi! Kam besim të pathyeshëm në ecjen e Kosovës. Kisha lodhje dërrmuese dhe ndjenja të përziera. Isha mes botës reale. E dija se babai po na linte dhe botës imagjinare assesi nuk doja t’i pajtohesha. I shoqëruar nga autoritetet e sigurisë së DHSK-së, shpejt ngjitem shkalleve në katin e dytë të klinikës. Nëpër korridor dhe shkallet lidhëse të kateve kishte njerëz që kishin qëlluar spontanisht, sigurisht për t’i vizituar të afërmit e tyre dhe mjekë e mjeke me të cilët në distancë, pa ndërruar fjalë, u përshëndetëm ngrohtësisht. Nxitimthi do të gjendem në dhomën ku ishte vendosur babai. Ishte duke më pritur me padurim. Ashtu i shtrirë përqafohemi gjatë, me aq fuqi që i kishte mbetur. Dukej i buzëqeshur, i emocionuar, thellësisht i prekur shpirtërisht. Unë u ndjeva i pafuqishëm dhe i mundur fizikisht dhe emocionalisht. Pandehja se do të qëndroja i fortë, por jo nuk mund t’i ndalja lotët. Që të dukesh më i freskët shpejt shkova në banjë, fshiva lotët dhe pastrova fytyrën. Zoti më dha forcë për t’i përballuar ato çaste. Në dhomë ishin edhe nëna dhe Lumja. Nëna ulur në karrigen me rrota dhe ngjitur me shtratin me babanë shtrirë. U ula buzë shtratit.

Disa herë më pyeti “A je kthy me shokët?”. Duhej t’i thosha “po”. U gëzua si fëmija

Babai dukej i rrënuar fizikisht, por nuk vërejta sflitje shpirtërore. Aftësia në të folur i ishte dobësuar shumë. Pozitiv në ato pak gjëra që flisnim. I kishte ndodhur një përmirësim pothuajse imagjinar para largimit nga bota tokësore e cila tanimë ishte çështje jo ditësh, por orësh. Me ne qëndroi mjeku, Kastrioti, gjatë gjithë kohës. I lutem Zotit dhe përulëm me respekt për mjekët dhe gjithë stafin ndihmës që e mbajtën gjallë derisa u takuam. Me përjashtim gjatë fëmijërisë sime të hershme dhe atë pa të keq nuk e kisha gënjyer, atë ditë u detyrova nga dashuria, që kur të largohesha, të mos ndihej i braktisur. Vdekja sikur nuk bënte pjesë në planet e tij mendore dhe të ndërgjegjes. Edhe në ato orë ndjeva veç dashuri aspak dëshpërim. Disa herë me pyeti: “A je kthy me shokët?”. Duhej t’i thosha “Po”. U gëzua si fëmija. Derisa Lumja e ushqente me supë, dëshironte të fliste e të fliste me mua me gjithë fuqinë e mbetur. “Shumë mirë që qenkan lëshu krejt shokët”, e përsëriti disa herë atë ditë. Ishte i përmbushur. Kur erdhi koha për t’u përshëndetur e që të largohesha, më lehtë i thashë: “Po shkoj në Burojë, të pres atje për çaj”. M’u përgjigj: “Shumë mirë, shko se edhe unë vij me

kismet shpejt, nuk kam çka me nejt këtu”. Me çdo kusht dëshironte të kthehej në shtëpi. U përqafuam dhe u përshëndetëm si babai me djalin. Kur dola te dera u ndala edhe një herë, e shikova drejt në sy. I kishin shtrënguar duart e njëri-tjetrit me nënën, sikur të ishin adoleshentë të dashuruar. Shikimi i tij pushtoi gjithë qenien time. Ajo buzëqeshje do të më përcjell përjetësisht. E dija se ishte vështirimi i fundit. Ishte shikimi lamtumirës. Ndjeva dhimbjen e thellë të zemrës dhe njejve të gjymtyrëve të trupit.

“Sot i them, babë, edhe për këtë mungesë të paarsyeshme (në varrim), jam plotësisht i pafajshëm”

Adriatik Kelmendi: Ju nuk ishit të pranishëm në funeralin e babait, sepse nuk u lejuat. Si e komentoni këtë rrethanë? **Hashim Thaçi:** Pas pak kohe babai u nda nga jeta në paqe, i rrethuar me dashuri nga familja bërthamë, nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e mjekëve. Ai shkoi me brengën time. Homazhet lamtumirëse dhe akademinë përkujtimore e përcolla në TV nga vetmia e qelisë. Flamuri kombëtar dhe shtetëror i shkonin për hijeshi mbi arkivol. Falënderime dhe respekt për të gjithë ata dhjetëra e mijëra njerëz që ndan dhimbjen dhe solidaritetin me familjen. Unë nuk arrita ta prisja babën as të gjallë as të vdekur në vendlindje, as një grusht dhe nuk arrita ta hedhja gjatë

ceremonisë së varrimit. Rendi e donte të isha i pari ta prisja në Burojë siç i kisha premtuar, po shkova i fundit. Sot i them, babë, edhe për këtë mungesë të paarsyeshme, jam plotësisht i pafajshëm. Kështu iku baba - njeriu më i dashur, i adhuruari, frymëzuesi dhe mbrojtësi im.

Adriatik Kelmendi: Dhjetëra mijëra qytetarë prej gjithë Kosovës dhe më gjerë morën pjesë në ceremoninë e varrimit dhe në ngushëllime. Si e vlerësoni? **Hashim Thaçi:** Pas tri dite, me lejen e DHSK-së, e vizitova vendlindjen. Në varrezat e reja të fshatit ishte shtuar një varr i ri. Qëndrova në nderim 9 minuta në rrethana të pazakonta e të paimagjinueshme. Një minutë nderim për çdo dekadë të jetës së tij. Pjesëmarrja e madhe e qytetarëve në ceremoninë mortore kishte bërë që toka dukej e rrahur, por e qulltë. Lulenderimet dhe mbishkrimet në kurora mbi varr ende ishin të freskëta. Lexoj nderime nga Prishtina, Tirana, Shkupi, Ulqini, Presheva, diaspora etj. Dielli shkëlqente atë ditë prag-pranverore. Ajri, pemët dhe toka kishin marrë aromë shiu. Pas pak në shtëpi, në Burojë, takoj nënën. Jo e lehtë - qëndronte e fortë dhe e qetë. Ngushëlluam njëri-tjetrin. Fjalët që atë ditë më përsëriste ishin: “Lum baba yt për vete, e lum ti për babën”. Drekuam së bashku. Shumicën e kohës e kaluam ulur në kopshtin e oborrit. E ndieja thellësisht dashurinë e saj dhe

ngrohtësinë e shkëlqimit të rrezeve të diellit. Atë ditë disi ndihesha me faj, sepse shpesh kam qenë burim i shqetësimeve për ta, para, gjatë dhe pas luftës. Gjatë fluturimit, duke u kthyer në Hagë, isha zhytur në mendime të pafundme për babanë. Nuk është fshehtësi, vdekja e tij më ka ndryshuar shumë - është zbrazëti që nuk po e mbush assesi. Po jetoj me ndjesinë dhe pikëllimin. Koha nuk po e zbut, po e ruan dhimbjen. Mendoj për ditët e mëhershme kur ishte gjallë. Ndiej një ringjallje të tij në jetën time. Ai la dritë e cila nuk do të fiket kurrë në familjen tonë. Por sot ky është fatalitet, jo fat imi në këtë fazë të jetës. Jam i vetëdijshëm se mërzia dhe burgu nuk shkojnë bashkë. Nuk harroj që nëse jo trupin, kudo dhe në çdo rrethanë mendjen e kam të lirë për të menduar, por të kufizuar për t’u shprehur.

“(Këtu) askush nuk hap tema të politikës ditore, edhe nëse ndodh rastësisht askush nuk bëhet pjesë”

Adriatik Kelmendi: Po bëhen pesë vjet që nga koha kur jeni duke u mbajtur në burg në Hagë. Si e keni përballuar deri më tash? **Hashim Thaçi:** Nuk është enigmë, fati që po përjetoj tejkalon veten time. Është i pandarë me rrugën e kaluar për liri dhe pavarësi të popullit të Kosovës. Interesant përsëri nga



Kosova po nxirren shembuj brengosës. Të jam mirënjohës, Adriatik, që më gjete edhe në këto vrima të thella të pasmureve dhe hekurave të lartë të Hagës.

Si e kalojmë kohën? Komentojmë ndonjë libër apo artikull së lexuari së fundmi. Ndonjë dokumentar apo film që është shfaqur rishtazi. Megjithëse edhe këtu prirjet dhe shijet e njerëzve janë të ndryshme. Është interesant, askush nuk hap tema të politikës ditore, edhe nëse ndodh rastësisht askush nuk bëhet pjesë - me abstenim mbyllet shpejt. Këtu ke kohë për të menduar dhe diskutuar për gjithçka që do.

Të mos keqkuptohem, ky ambient ngjan edhe si shtëpi pleqsh ku jo rrallë luhet letra, shah, lexon apo shfleton çdo gazetë që të bie në dorë, merresh me zgjidhje fjalëkryqesh, zhvillohen biseda familjare dhe rreth aktualitetit, dhe ku jo rrallë bëhet edhe muhabet koti, je i privuar nga aktiviteti për jetë normale, komunikim e lëre më pjesëmarrje në botën e jashtme. Përpiqem të kaloj një rrethanë më ndryshe seç fola më lart. Të jem sa më pozitiv me veten dhe të tjerët - mendoj sa më shumë për gjëra të bukura. Këtu është e vështirë të bësh gjëra të dëshirueshme dhe ndërtuese. Jeta e vërtetë është jashtë kësaj kornize hapësinore.

Adriatik Kelmendi: *Çfarë ju ka munguar apo jeni privuar, përveç lirisë, gjatë kësaj kohe që jeni në burg?*

Hashim Thaçi: Jetën e re e kaloj në kornizat e rrethanave të reja jo vetëm fizike, por edhe leximit, mendimeve dhe meditimit, që kapërcejnë muret e qendrës së paraburgimit, që fillon nga vendlindja si fillim i botës dhe atdheut tim. Kultivoj përvojën e të menduarit dhe vështirësitë për botën dhe shoqëritë përmes leximit të librave të zgjedhur dhe përfaqësues. Mendja më ngulitet, bëj shëtitje dhe stërvitje të muskujve të trurit nëpër histori të popujve dhe civilizimeve për ta pikasur mbijetesën dhe formësimin e shqiptarëve me ndjenjën dhe përcaktimin perëndimor. Aty e gjej edhe fatin dhe rolin historik, të sotmen dhe të ardhmen edhe të shtetit të Kosovës.

Gjatë ditës bëj telefonata familjare, në kohën e lejuar nga DHSK-ja pres në vizita familjarë dhe miq, paradite ose në mbrëmje bëj palestër; në kuzhinë nuk kam qenë për t'u lavdëruar, tash jam përmirësuar goxha. Kur e kam të nevojshme për lëndën e akuzës, bëj konsultime me ekipin mbrojtës, marr pjesë rregullisht në seancat gjyqësore, të cilat më janë bërë art i ri i formësuar në jetën time. Pastrimin dhe hekurosjen e teshave e bëj pa përtesë. Dhomën e qëndrimit



në paraburgim mundohem ta mbaj sa më të pastër. Kujdesem edhe për pastërtinë e shtrojës dhe mbulojës. Në muret e dhomës mbaj një foto të përbashkët të rrethit të ngushtë dhe të gjerë familjar, të cilët më vështrojnë dhe i shikoj gjatë gjithë kohës, kështu komunikojmë mes vete; ata janë frymëmarrja, energjia dhe drita ime edhe në momente më të liga që mund të kaloj këtu, mes katër mureve betoni të ngushta, të ftohta, të errëta dhe derës së hekurt të qelisë.

Në televizor përcjell futboll, tenis dhe gjatë dimrit garat e skijimit. Përsëri lexoj apo shkruaj diçka, dëgjoj muzikë të zhanreve të ndryshme, popullore, klasike, folklor, jazz etj. Lexoj rregullisht gazetën “Politico” të sjellë nga DHSK dhe më herët ditoren “The New York Times”, të parapaguar nga ana ime. Në mbrëmje ndodh që shikoj ndonjë film apo dokumentar. Por, mundohem t'i ik sa më shumë shprehisë për t'u ulur përpara televizorit, e cila mund të sjellë dembeli dhe ngufatje mendore.

Mediet lokale, i përcjell pak ose fare. Përpiqem të qëndroj sa më larg jehonës apo ndikimeve të zhurmave të grumbullit të njerëzve tanë. Çdo zhvillim i mirë për Kosovën më gëzon, sikurse çdo gjë jo e mbarë më bën të ndihem jo rehatshëm, ma ndan zemrën në dysh, edhe pse arrij të rezistoj e të mbahem në këmbë, por janë plagë që nuk shërohen e mbyllen lehtë.

“Mendjen, shpirtin dhe trupin nuk ua dorëzoj rrethanave izoluese”

Orarin e shëtitjes në ajër të pastër nuk e humb kurrë, qoftë moti me vapë, shi, erë apo borë, megjithëse këtu borë bie shumë rrallë dhe shkrihet shpejt. Shiu është i rrëmbyeshëm, i përcjellë me erë të fortë e, ndonjëherë, edhe i acartë, por nuk më ndalon në ecje. Tani më janë stërvitur veshët me zhurmën e erës, e cila përsëritet... përsëritet e përsëritet në çdo stinë. Vapa nganjëherë ndodh të

jetë përcëlluese dhe lagështia ngufatëse. Në këto hapësira nuk e ndiej ngrohtësinë e rrezeve të diellit. Gjumin e bëj rehatshëm. Në ushqim nuk jam ndonjë nazeli i madh. Rrallë përdor ushqimin e ofruar nga burgu. Porosisim sipas dëshirës nga mundësia e ofruar njëherë për gjithë javën. Duhan nuk kam përdorur, tash e refuzoj edhe më tepër. Përdor çajra të ndryshme. Ndërsa frutat dhe perimet janë të pazëvendësueshme edhe këtu.

Kur është koha e mirë luaj tenis. Më herët, si nxënës dhe student, kam luajtur pingpong. Tenis po luaj për herë të parë këtu. Jam i mirë dhe goxha preciz në sulm, por jo edhe aq në kthimin e topit. Ky sport më vë në lëvizje gjithë muskujt e trupit, aq e domosdoshme për rrethanat e pasivitetit. Edhe “loja me flutura” më inspiron. Për futboll apo basketboll jemi të hendiëkuar, se nuk mund t'i bëjmë dy ekipe për lojë. Nganjëherë bëj lojën solo në basketboll me gjuajtje në kosh... ende mbahem mirë me shënimin e tresheve... Mendjen, shpirtin dhe trupin nuk ua dorëzoj rrethanave izoluese; ruaj gjallërinë, fuqinë fizike dhe freskinë mendore, që në asnjë rrethanë të mos më pllakos molisja apo, larg qoftë, të shterëm. Një nga synimet apo rreziqet në të tilla procese është shtyrydhja, shterimi, dorëzimi deri te kalimi gradual në fazën e sublimes. Çdo aktivitet që e bëj edhe këtu përpiqem ta përjetoj.

Festat kombëtare, 28 Nëntorin apo 17 Shkurtin, apo ditët fetare dhe atë të ndërrimit të moteve, i vetorganizojmë sipas rrethanave në mënyrë modeste. Natën e Vitit të Ri u befasova me shumë fisheqzjarrë në qytetin e Hagës sesa në Prishtinë. Nuk jam ithtar i organizimit të ndejave të gjera apo të zhurmshme, por më mungojnë urimet fizike dhe përqafimet familjare. Për 21 vitet (1999-2020) që i jetova dhe gëzoja lirinë e Kosovës, gati të gjitha eventet familjare apo festat

kombëtare i kam kaluar në vendlindje, përpos gruas dhe djalit, gjithmonë kam pasur dëshirë të jem afër dhe të ngre dolli edhe me prindër dhe me familjarë të tjerë.

Është jo e lehtë të jesh larg familjes dhe njerëzve që i do dhe të duan. Larg nga vendi ku ke lindur dhe rritur. Ndihej i bekuar nga fati historik që linda dhe u rrita në Kosovë (Drenicë), vend të cilin e dua shumë. Por ky fakt gjeografik nuk i jepte jetës sime kuptimin e plotë përtej kësaj hapësire prej më të izoluarve dhe të pazhvilluara në ish-Jugosllavi. Vetëm kah mesi i viteve të thjeshta kur vizitova vëllezërit në Vjenë dhe motrën në Paris u bëra i vetëdijshëm se e ndieja veten evropian. Edhe Kosova mund të bëhej evropiane. Por, fillimisht, duhej ta fitonim lirinë.

Lumja dhe Endriti më vizitojnë çdo muaj, dy apo tre ditë radhazi. Ky është çmimi që po paguan familja ime dhe e të burgosurve të tjerë - udhëtim 4 000 km ardhje-kthim për një vizitë. Vizita të rregullta kam edhe nga rrethi i gjerë familjar; më vjen keq që nuk kam mundësi t'i takoj të gjithë për shkak të kufizimeve procedurale. I falënderoj shqiptarët jashtë vendit për interesimin, mbështetjen dhe vizitat që më kanë bërë. Vetëm ata që kanë qenë në burgje e dinë, e për këtë fakt kosovarët mbajnë rekord evropian për numër të banorëve në Evropë në vitet 1945-1990. Se nuk ka asgjë më frymëzuese për një të burgosur sesa kur për kauzën e drejtë për të cilën mbahesh brenda, krijohet konsensus qytetar jashtë.

Këshilla refren (e miqve ndërkombëtarë) ishte: “Mendo, beso, shiko kah e ardhmja”

U jam mirënjohës edhe miqve ndërkombëtarë që kanë ardhur nga kryeqendra të ndryshme evropiane apo ShBA-ja... këshilla refren i të gjithëve ishte: “Mendo, beso, shiko kah e ardhmja”. Ata e kanë ruajtur

besimin për Kosovën dhe mua, kjo më bën të ndihem mirë.

Tash së fundi, një miku im diplomat ndërkombëtar, pas vizitës së tij më kishte dërguar edhe dy libra të shkëlqyer “HOMELANDS” nga autori Timothy Garton Ash, një rrëfim personal unik evropian para dhe pas rënies së perdes së hekurt, si dhe librin “LUKA - a Novel”, shkruar nga diplomati dhe shkrimtari britanik Lan Bancroft, njohës dhe përjetues i jashtëzakonshëm i ngjarjeve të ish-Jugosllavisë, në veçanti të Kosovës. Edhe pse ngjarjet e rrëfyera dhe karakteret janë fiktive në librin e Bancroft, kanë shumë ngjashmëri me atë çfarë ka ndodhur në Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë apo në Kosovë, si në luftë dhe paqe, dhe domosdoshmërinë për drejtësinë, paqen dhe pajtimin mes popujve, duke ruajtur gjithmonë shpresën si dritë në fund të tunelit. Edhe përkundër abuzimeve, dhunës gjatë dekadave, ai sjell mesazhin: “Po dashurisë, jo urrejtjes” mes njerëzve me përkatësi të ndryshme etnike, fetare dhe sociale.

Miq të ndërkombëtarë gjejnë forma të ndryshme publike, private apo edhe përmes vizitave për të më uruar përvjetorët e pavarësisë së Kosovës.

Jam prekur dhe emocionuar shumë prej përmbajtjes së letrave apo kartolinave që kam pranuar nga nxënës, studentë nga Kosova, Shqipëria dhe qytetarë nga diaspora, në rastin e përvjetorëve të Pavarësisë së Kosovës. Unë ju them - ju dua shumë, jetoni lirinë, ruajeni dhe afirmojeni me integritet dhe dinjitet shtetin. Ndërsa unë këtu ku jam përpiqem ta jetoj realitetin, e jo iluzionin që mund të ma gërryen shpirtin në vetminë e qelisë. Gjithmonë e ruaj vetëdijen e fillimit të ri, e assesi atë të fundësisë.

“Jam i vetëdijshëm, jeta nuk rikthehet, por shpirtin mund të ma marrë veç ai që ma ka dhënë”

Ky është çmimi i përballjes së mëhershme me tiraninë. Unë sot jam i privuar përkohësisht, por populli im është i lirë përjetësisht. E sotmja dhe e nesërmja assesi nuk do t'i i kundërvihen të djeshmes sime. Si i burgosur, njeriu është si peshku pa ujë, qelia është acar i jetës, e bën të vetën. Burgu, kjo jetë e re në botën e re jo të këndshme, e çuditshme dhe e huaj. Në këto rrethana izolimi, errësire dhe vetmie, gjërat ngatërrohen me brishtësi dhe pasion. Ende po arrij ta maksimalizoj shpresën dhe angazhimin dhe minimizoj tendencën e mërzisë dhe kotësisë.

Mund të tingëlloj naiv apo absurd, por kurrë ritmi i jetës



sime nuk ka lëvizur më shpejt sesa periudha që kam kaluar këtu por, për fat të keq, janë vite “qetësisht” dhe “butësisht” të humbura. Është kohë e humbur jetësore prej më të mirave dhe më efektive që mund ketë qenia njerëzore vite pa mision të zgjedhur nga ana ime. Jam i vetëdijshëm, jeta nuk rikthehet, por shpirtin mund të ma marrë veç ai që ma ka dhënë.

Adriatik Kelmendi: *Si e keni menaxhuar shëndetin tuaj mental dhe emocional gjatë këtyre viteve në Hagë, larg nga vendi?*

Hashim Thaçi: Në burg cikli i ditëve është i vrullshëm, jeta e shpejtë si vetëtimja. Vend paradoksesh. Koha vjen dhe ikën pahetueshëm, por ngjan që ndonjë ditë thuajse kurrë nuk përfundon. Dita e sotme ngjan me të djeshmen dhe të nesërmen, apo siç ka theksuar N. Mandela, në burg “Java i ngjan javës, muaji-muajit, viti-vitit”. Të njëjtut njerëz, ambient, atmosferë dhe protokoll.

Ndryshojnë vetëm dita nga nata, stinët dhe moti. Librat apo lajmet e ndryshme që lexon apo dëgjon.

Të djeshmen e kaluar këtu nuk e mendoj, nuk më duhet as e nesërmja. Është e përjetuar koha disi e zhvesh njeriun, por jam në paqe me ndërgjegjen time dhe në raport me të tjerët. Këtu nganjëherë ndodh mbivendosje kohe dhe gjërash, por ruaj një rend objektivash në mendjen time.

Duhet kuptuar, impulsi i brendshëm dhe jashtëm i të burgosurit çdoherë ka etje lirie. Disponimi në burg është ujë i paktë. Të mungon thithja e ajrit të lirisë.

Adriatik Kelmendi: *Nëse do të ktheheshit prapa dhe do të ishit në dijeni se do të akuzoheshit nga Gjykata Speciale, a do t'i kërkonit sërish Kuvendit të Kosovës themelimin e Gjykatës Speciale të kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare, para së gjithash nga ShBA-ja?*

Hashim Thaçi: Dua ta depersonalizoj këtë çështje. Procesi i themelimit të kësaj gjykate nuk ishte disponim apo vullnet individ, por përgjegjësi ose jopërgjegjësi shtetërore dhe kombëtare përballë vetes sonë dhe partnerëve ndërkombëtarë. Ka dallim epokal të rrethanave ndërkombëtare të vitit 2015 dhe zhvillimeve botërore sot më 2025, duke përfshirë edhe qëndrimin e ShBA-së, BE-së dhe OKB-së në raport edhe me Kosovën.

Kosova ishte përballë dy sfidave: të themelojë këtë gjykatë vetë në koordinim me ShBA-në dhe Bashkimin Evropian, ose Kosovës do t'i imponohej një gjykatë e njëjtë, por e themeluar nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, me rol aktiv të Rusisë dhe



Kinës, por që do të përkrahej edhe nga ShBA-ja dhe BE-ja. Kosova bëri zgjedhjen e parë që ishte shumë sfiduese, por më e përgjegjshme. Me garanci nga partnerët amerikanë dhe evropianë se do të punohet me legjislacionin kosovar, pra jo vetëm të merret parasysh por, nënvizoj, detyrimisht të respektohet.

Sikur të ndodhte e kundërta, Kosova do të akuzohej nga shumëkush se pse ju dha kjo mundësi Rusisë dhe Kinës. Gjithashtu, një gjykatë e tillë do të ishte në kuadër të Rezolutës 1244, kjo do të shënonte kthim prapa për Kosovën. U përballëm me situatë: “Hip se të vrava, zbrit se të vrava”. Pse u gjendëm në këtë gjendje, sot unë nuk mund të flas. Por, me asnjë çmim nuk do të mund të tolerohej që një vendim i tillë të sfidohej nga Kuvendi i Kosovës e të vulohej nga Këshilli i Sigurimit institucion ndërkombëtar aktualisht i disfavorshëm për Kosovën.

Nga dita e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës ne kemi kërkuar këmbëngulësisht largimin e UNMIK-ut, në veçanti nga koha e përmbylljes së suksesshme të procesit të mbikëqyrjes së pavarësisë në vitin 2012.

Ju me të drejtë pyesni sikur të mund të kthenim kohën prapa, a do të vepronit në të njëjtën mënyrë? Të jem kristal i qartë, në raportin e senatorit zviceran D. Marti përmendesha disa herë, si qindra të tjerë, edhe unë mund të futesha nën hetim, por e kam ditur se nga raporti nuk do të akuzohej askush, sepse akuzat ishin të pabaza, siç edhe u vërtetua me vonë. Por me kalimin e kohës gjërat morën drejtim dhe trajtim tjetër, ndodhi ajo që ndodhi.

Si shumë të tjerë, kam sfiduar veten për interesa shtetërore. Qëndroj vertikal përballë çdo lajthitje të kujtdoqoftë. Sikur të bëja gjënë e kundërt, sot do të akuzohesha po prej të njëjtëve njerëz, se pse nuk u themelua gjykata nga institucionet e Kosovës bashkë me perëndimorët. Nuk kam asnjë dilemë. (Ka edhe shumë gjëra të

tjera të cilat nuk mund dhe nuk dua t'i komentoj).

Adriatik Kelmendi: *Kundërshtarët tuaj politikë ju kanë akuzuar nganjëherë si një lider që i ka pranuar gjithmonë kërkesat amerikane. Kryeministri Kurti shpesh ka marrë pozicion kundërshtimi ndaj kërkesave amerikane, mirëpo nuk po përballet me ndëshkim personal, megjithëse Kosova po paguan çmimin e sanksioneve nga Bashkimi Evropian. Si do ta komentoni këtë situatë?*

Hashim Thaçi: Raporti im me ShBA-në dhe Perëndimin ka qenë reciprok dhe jo i njëanshëm. E gjithë bota e di se ShBA-ja fillimisht ka dëgjuar me respekt e më vonë edhe i ka përkrahur kërkesat e popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi; këto çështje gjithmonë kanë qëndruar mbi çdo prioritet tjetër, rreth tri dekada të bashkëpunimit tim me ShBA-në.

Kërkesat e ShBA-së drejtura lidershit dhe popullit të Kosovës kanë qenë në të mirë të vendit tonë - të sinqerta dhe parimore, që lidheshin me interesat e të dy vendeve, për rend kushtetues dhe ligjor, harmoni etnike, fetare dhe qytetare, prosperitet ekonomik, shoqëri multietnike dhe integrimi i tyre në shoqëri dhe institucione, forcim i shoqërisë civile, media të lira, luftë kundër terrorizimit dhe radiklizmave të tjerë. Nëse ndokush e kupton realizimin e vullnetit të popullit për liri, pavarësi, para pak vitesh edhe themelimin e Ushtrisë së Kosovës, njohja nga 119 shtete dhe integrimi në organizatat ndërkombëtare si dëgjueshmëri apo servilizëm timin në raport me ShBA-në dhe Perëndimin - lëre që nuk ndihem i akuzuar, por ndihem shumë i nderuar.

Nuk jam bukëshkalë! Sa i përket pjesës së dytë të pyetjes suaj, në rrethanat që jam nuk dua të bëhem pjesë e debateve të politikës ditore. Këto që them sot janë vetëm opinione të lira personale të një qytetari, me ekspertizë në politikën e brendshme dhe në

rrafshin ndërkombëtar. Nuk jam aktor e as nuk pretendoj ta paraqesë faktorin.

“Ndihej i abuzuar nga ata që në emër të diçkaje fiktive pa të drejtë më shkëputën nga familja, më përjashtuan nga puna, m’i morën vitet më të bukura të jetës”

Adriatik Kelmendi: *A ndiheni i tradhtuar apo mashtruar nga Perëndimi, nga ShBA-ja?*

Hashim Thaçi: Jo, nuk ndihem as i tradhtuar, as i mashtruar. Ndihej i abuzuar nga ata që në emër të diçkaje fiktive, pa të drejtë më shkëputën nga familja, më përjashtuan nga puna, m’i morën vitet më të bukura të jetës. Perëndimi dhe ShBA-ja nuk servuan rrëfimin e lëndës. Kam punuar me disa administrata amerikane, efektivisht në raporte të shkëlqyera. Nga presidenti Clinton, mandati i dytë 1996-20, Bush i Riu, 2000-2008, Obama dhe Biden, 2008-2016, Trump, 2016-2020, në ngjarje dhe kohë të ndryshme në ShBA-në kam folur për Kosovën edhe me presidentin Bush i Vjetër dhe XH. Karter.

Kam punuar me shtatë presidentë të ShBA-së, pesë prej tyre në detyrë dhe me tetë sekretarë shteti, duke filluar nga M. Olbrajt deri te M. Rubio, më herët si senator. Me secilin prej tyre kam përvojë të veçantë. Ata iu përkasin taborëve politikë të ndryshëm, por për Kosovën kishin të njëjtin qëndrim. Një pozicion i tillë bipartizan nuk ndodh shpesh në DC. Kjo ka ndodhur në dekadat e fundit vetëm me Izraelin dhe Kosovën. Se si do të jetë më tutje - varet nga Kosova.

Sa i përket bashkëpunimit me Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera perëndimore, kam qenë interlokutori prej kryesorëve. Bashkëpunimin e vlerësoj cilësor. Kemi pasur edhe gjëra që nuk jemi pajtuar, për çka jam deklaruar edhe publikisht. Jam i sigurt se ShBA-ja dhe Perëndimi e duan Kosovën më të

përparuar. Asnjë intervenim ndërkombëtar nuk është treguar më i suksesshëm sesa në Kosovë. Është fakt i pamohueshëm, ishte punë e përbashkët e ShBA-së, NATO-s, BE-së dhe OKB-së. Por, pa rolin lider të ShBA-së Kosova mund të ishte ende provincë e Serbisë.

Adriatik Kelmendi: *Nëse kthehemi në retrospektivë, a ka ndonjë vendim politik apo personal që do ta merrnit ndryshe nga pozicioni ku jeni sot?*

Hashim Thaçi: Janë dekada të angazhimit politik. Nga distanca kohore është lehtë të flasësh për këtë fenomen që përcjell çdo lider. Në rrugëtimin e zbatimit të vizionit për liri dhe shtetbërje në parim dhe strategji nuk do të ndryshoja diçka me peshë, në planin taktik, periudhat kohore të vendimeve dhe aktorët - do të ndryshoja në raste të caktuara. Kam reflektuar për qëndrime të cilat sot nuk do t'i merrja, por gjithmonë duhet marrë parasysh kohën dhe rrethanat. Nuk kam bërë dy herë të njëjtin gabim. Kam mësuar dhe jam përmirësuar prej gabimeve. Gabimi është njerëzor, nuk paraqet faj.

Kam identifikuar raste që nuk do të duhej të isha pjesë e debateve joproductive dhe të zhurmshme. E di se opinionet apo vendimet e mia jo rrallë kanë ngjallur debat për dhe kundër, iu kanë munguar abstenimet, por e tillë është politika. Unë flisja atë që e mendoja dhe besoja, ndoshta nganjëherë para kohës së duhur e ndonjëherë pas, në raste të caktuara edhe nuk jam kuptuar drejt, apo ndonjë projekt e kam paraqitur në rrugën jo më të qëlluar. Por kjo u ndodh gjithë liderëve.

Po, kam bërë plot gabime, por nuk kam gënjyer dhe mashtruar. Nuk kam synuar ta bëj idealin. Besoj kam bërë realistin. Kam ecur paralelisht me parimorin dhe pragmatikën. Jam munduar të tregohem sa më pak egocentrik. Dua të nënvizoj: precizitet kohor dhe ndërlidhje faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm, në favor të shqiptarëve, ka ndodhur vetëm në vitet 1998-99 dhe 2008.

Përderisa isha figurë publike, më shumë do të indinjohesha sikur të injorohesha; përderisa ngjall debat, idetë janë me peshë, vlerë dhe shëndet për demokracinë.

“Për mua ka qenë me rëndësi bërja e shtetit...”, debatet për çështjet estetike apo të dizajnit më bëjnë të qesh...

Rivalitetin politik gjithmonë e kam çmuar. Ishte kënaqësi kur punoja me rivalët për çështje të përbashkëta nacionale. Kosova

në këtë drejtim për kohë të gjatë ka qenë shembull për rajon dhe më gjerë.

Opinionet se a duhej shpallur Pavarësia më 17 shkurt, apo në ndonjë datë tjetër? A duhej që Deklarata e Pavarësisë ta kishte këtë përmbajtje, apo tjetër? A duhej të kishte flamuri shtetëror këtë pamje, apo tjetër? Ta kemi këtë himn shtetëror, apo tjetër? A duhet përfaqësueset tona sportive t'i bartin fanellat me këtë, apo atë pamje? Këta zëra me frekuenca të shkurtra dhe të gjata do të vazhdojnë edhe kohë. Më bëjnë të qesh, por i pëlqej. Ky debat për çështje estetike apo dizajni, është atraktiv, por më tepër janë shfaqje egosh... por nuk do të bëhem pjesë.

Kosova vetëm në drejtimin që ka ecur është pranuar dhe njohur nga bota, në të kundërtën do të kishim shumë pikëpyetje për të djeshmen, e më shumë për të sotmen dhe nesërmen tonë. Pa u futur në ujë, nuk mësohet noti.

Për mua ka qenë me rëndësi bërja e shtetit. Por kjo më nxiti t'i krahasoj opinionet e shfaqura tash e mbi 100 vjet, se a duhej Pavarësia e Shqipërisë të shpallej më 28, apo 26 nëntor? Pse nuk u shpall në Shkodër, Durrës, por u zgjodh qyteti i Vlorës? A e qëndisi flamurin kombëtar Marigona, apo e nxori nga sënduku ndonjë çifligar? Pse u shpall pavarësia para se të mbërrinte Isa Boletini me luftëtarët e tij nga Kosova, apo a është gjunjëzuar ai para flamurit, e ka puthur apo s'e ka puthur flamurin? Pse pavarësinë e shpalli Ismail Qemali e jo X, Y, ose shkojnë edhe më larg duke i akuzuar themeluesit e shtetit se pse mbeten dy të tretat e tokave shqiptare jashtë hartës zyrtare të Shqipërisë londineze etj.

Nuk është çudi, që aty këtu dëgjojmë apo lexojmë edhe ligjërime, “sikur të mos ndodhnin kryengritjet e Skënderbeut, shqiptarët do të kalonin më lehtë... historinë e dekadave dhe shekujve vijues”, sa çel e mbyll sytë injorohet nga injoranca apo dashakeqësia e vërteta monumentale se Epoka e Skënderbeut e vulosi identitetin evropian shqiptar, që veç tash pas pesë shek. mezi po e zyrtarizojmë me letra si shtete. Jam i vetëdijshëm se ky nuk është debati im, as koha dhe as vendi për të folur.

“Në raport me ndërkombëtarët nuk do të ndryshoja asgjë... por di të them edhe ‘po’ ose ‘jo’ të pakthyeshme. Në disa raste kam paguar çmim personal dhe politik”

Në raport me ndërkombëtarët nuk do të ndryshoja asgjë, shtetbërja e Kosovës dhe integrimi në strukturat



euroatlantike ka qenë, është dhe do të mbetet i pandashëm. Kam kërkuar gjithmonë rrugë bashkëpunimi. Për gjërat që nuk jam pajtuar - i kam thënë në shumicën e rasteve në takime të mbyllura. Ata që më njohin më nga afër e dinë se unë jam bashkëbisedues shumë i lehtë dhe fleksibil, por di të them edhe “Po” ose “Jo” të pakthyeshme. Në disa raste kam paguar çmim personal dhe politik. Shumica e politikanëve të Kosovës dhe aktorët ndërkombëtarë e kanë përjetuar këtë fakt.

Për disa gjëra për të cilat do të flisja me ëndje, për t’u përgjigjur më drejtpërdrejt pyetjes sate, mendoj se duhet të kalojë ende kohë. Por rrethanat prej vendit ku unë flas nuk do të kuptohesha drejt. E di se do të nxiste debat shumëdrejtimësh. Unë jam i izoluar. Do të ishte shqyrtim i njëanshëm i çështjeve. Disa gjëra edhe nuk dua t’i komentoj.

Adriatik Kelmendi: *Gjatë karrierës suaj politike keni qenë figura qendrore e negociatave për Pavarësinë e Kosovës. A mendoni se sakrifica juaj, duke përfshirë burgosjen, është çmimi që do të duhej të paguani për atë që ka arritur Kosova deri tash?*

Hashim Thaçi: Në Hagë nuk jam hero i as martiri. Sfidat ime është ballafaqimi për historinë e drejtësisë së lirisë dhe Pavarësisë së Kosovës. Nëse veç ishte paracaktuar që Kosova të paguante çmim, atëherë le të mbetem unë kurban. Por një gjë e di dhe nuk ka njeri në këtë botë që më bind për të kundërtën: liria e Kosovës ka ndihmuar në demokratizimin më të shpejtë edhe të të gjithë rajonit, zgjerimin dhe forcimin e vlerave civile. Madje ka ndikuar edhe në largimin më të shpejtë të Millosheviqit nga pushteti dhe fillimin e tranzicionit demokratik edhe në Serbi. Por, edhe nga këtu e shoh dhe e kuptoj shtegun e popullit, shtetit të Kosovës dhe jetës sime.

Jam edhe më i bindur në drejtësinë e këtij përcaktimi, të cilin duhet çdo ditë ta mbushim me përmbajtje të vlerave civile.

Jam këtu jo për atë se kam bërë ndonjë plan të gabuar, por për atë se kush kam qenë, kë dhe si e përfaqësoja dhe, ndoshta, edhe kush jam, apo edhe se kam ndryshuar shumë në taktikë, por kam mbetur po ai që kam qenë në strategji për të mirën e shtetit dhe qytetarit. Dikush tha: “Ke bërë hapa më të shpejtë seç duhej bërë”. Narrativat historike dhe agjendat politike në sistemet demokratike nuk marrin përgjigje përmes burgjeve. Edhe në këtë situatë dhe çdoherë unë do t’i besoj drejtësisë. Nga dita e parë nuk e kaloj kohën duke e menduar veten nxitimthi, por me durim.

Adriatik Kelmendi: *Procesit gjyqësor ngadalë po i afrohet fundit; a shpresoni ende se gjykata dhe ky panel do të nxjerrin vendim bazuar në fakte dhe jo të dirigjuar me direktiva politike?*

Hashim Thaçi: Tani që procesi gjyqësor është në fazë të rëndësishme kohore dhe substanciale, shpresoj të jetë i drejtë, transparent, jo i mbyllur, jo keqinterpretues dhe i çliruar nga çdo paragjykim dhe i gabimeve potenciale. Qytetarët e Kosovës presin dhe duan detyrimisht që Dhomat e Specializuara ta respektojnë Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës në vendimmarrjen e tyre.

Të respektohen të drejtat e njeriut dhe të drejtat civile. Qytetarëve në Kosovë, por dhe opinionit ndërkombëtar, medieve të lira, shoqërisë civile, organizatave të të drejtave të njeriut, duhet t’u krijohet mundësia ta shohin këtë proces gjyqësor për t’i besuar të vërtetës dhe vetëm të vërtetës të bazuar në fakte dhe jo në keqkonceptime. Edhe në këtë gjykatë duhet t’u jepet përparësi fakteve dhe të vërtetës mbi indinjatën apo misionin e çfarëdo natyre qoftë.

Adriatik Kelmendi: *Si e shihni rolin e Gjykatës Speciale në të ardhmen e Kosovës? A mendoni se do të ndikojë në besimin qytetar ndaj drejtësisë ndërkombëtare?*

Hashim Thaçi: Hendikepi i kësaj

gjykate është mungesa e një mekanizmi kujdestarie legjislativ, që me përpikëri do ta zhvendosnin barometrin në favor të fakteve reale e jo pretenduese apo imagjinare. Faktet duhet të vlerësohen sipas bindjes juridike dhe jo të interpretohen sipas dëshirës apo përcaktimit paraprak. Çdo vendimmarrje në emër të drejtësisë me besim, bindje apo legjitimitet të lëkundur apo të humbur qytetar, në çdo vend dhe shoqëri demokratike, gjithmonë është dhe mbetet i diskutueshëm dhe i kompromitueshëm.

Mbetet i gjykueshëm dhe shembull për studiuesit në historinë e drejtësisë, se çka nuk duhej të ndodhte dhe model se çka nuk duhet të lejohet të ndodhë në të ardhmen në një shtet dhe shoqëri me standarde demokratike.

Mbi Kushtetutën dhe ligjet nuk duhet të qëndrojnë askush. Mbi këtë parim është edhe vetë themeli i krijimit të Bashkimit Evropian. Besoj do të respektohet edhe nga DHSK-ja. Pra, duke njohur dhe respektuar ligjin e nxjerrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe ndryshimet kushtetuese të vitit 2015 në mënyrë origjinale e jo në mënyrë të dëshirueshme.

Adriatik Kelmendi: *Këtu në Kosovë kanë ndodhur shumë zhvillime politike, por pak përparim. Shtetndërtimi thuajse është paralizuar. A keni pasur mundësi t’i përcillni këto zhvillime? Nëse po, cili është opinionin juaj?*

Hashim Thaçi: Sot kam një raport pothuajse platonik me Kosovën, Shqipërinë dhe më gjerë. Kjo ma determinon edhe mungesën e informimit të shpejtë, të saktë dhe të plotë. Gjendjen atje e vlerësoj, si një qytetar i saj peng, jashtë vendi. Kryesisht i informuar nga mediumet ndërkombëtare. Jetoj në një heshtje të zhurmshme, ku çdo fjalë apo fjali që e dëgjoj apo e lexoj për Kosovën në këtë vetmi më krijon zhurmë, që e gëlltit me frymëmarrje të thellë. Në tri vitet e fundit bota ka ndryshuar gramatikisht. Nuk

është më ajo që e kemi jetuar për gati një shek. Kosova do të duhej të nxitohet në rikonsolidimin e brendshëm dhe afirmimin ndërkombëtar, e kundërta, mund të ndodhin deformime demokratike dhe ngërç ekonomik.

Se si do ta gjejë veten Kosova në këto ndryshime mbetet të shihet. Uashingtoni dhe Brukseli, nëse vazhdojnë të punojnë së bashku në raport me Kosovën në katër vitet e ardhshme, duket se mund të jenë më të padurueshëm me zyrtarët në Prishtinë. Do të jetë e drejtë apo jo kjo qasje është e diskutueshme, për fat të keq, çmimin mund ta paguajnë qytetarët e saj.

Nëse Uashingtoni vazhdon qëndrimin vetëm në mbështetje të Bashkimit Evropian me rol udhëheqës, kjo do të nënkuptonte që vitet e ardhshme do të kalojnë duke u marrë me sanimin e pasojave të pesë viteve të kaluara - vështirë për të bërë diçka për të ardhmen. Është fare e lehtë edhe mundësia e injorimit apo marrjes sa për sy e faqe me Kosovën - një lloj menaxhimi i situatës apo krizave lokale. Kjo mund të jetë edhe më me pasoja, vendi mund të kalojë në një fazë të padëshirueshme, të ziej në vorbullën e ujit që nuk lëviz. Humbja e kohës është çmim i madh për Kosovën.

Marrëveshja finale Kosovë - Serbi është e domosdoshme. Ndërkombëtarët do duhej t’i ndreqnin gabimet që ndodhën në këtë proces gjatë viteve të fundit. Ata, me ose pavetëdije, dialogu mes Kosovës e Serbisë lejuan që të shndërrohet në kauza elektorale në vendet përkatëse. Kjo jo që nuk solli përmirësim mes këtyre dy shteteve dhe popujve, por futi përçarje edhe në politikën dhe brenda shoqërive të të dy vendeve. Ky proces mund të ketë sukses veç kur do të ketë agjendë dhe merr kuptim të qartë perëndimor.

Deri para pak vitesh relacionet Kosovë me bashkësinë ndërkombëtare kishin një kthjelltësi monumentale. Sot sikur po ndodh një zvetënim moral dhe politik.

Marrëveshja e Uashingtonit të zbatohet, roli i ShBA-së i pazëvendësueshëm... BE-ja “sikur po e inkurajon Serbinë të sillet jo mirë me Kosovën”

Marrëveshja e Uashingtonit në mes të Kosovës dhe Serbisë e shtatorit 2020 do të duhej rikthyer për zbatim. Është marrëveshje e mirë ekonomike për të dyja vendet. Zbatimi i saj herët a vonë do të dërgonte pashmangshëm në njohjen reciproke. Dialogu mes shteteve dhe popujve zhvillohet për t’i ulur armiqësitë dhe tensionet;

në vitet e fundit ndodhi e kundërta. Do të ishte me interes që shqiptarët dhe serbët të keqen mes tyre ta lënë pas. Roli udhëheqës i Uashingtonit në dialogun Kosovë - Serbi është i pazëvendësueshëm.

Bashkimi Evropian është ende jounik për njohjen e shtetit të Kosovës, duket i përgjumur dhe i vonuar për integrimin e Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Mosgatishmëria e njohjes së Kosovës nga pesë vendet e Bashkimit Evropian, sikur po e inkurajon Serbinë të sillet jo mirë me Kosovën.

Tash duhet punuar shumë për ta merituar anëtarësimin në NATO. Por është jologjike të pretendosh anëtarësim në NATO, me sanksione në fuqi nga Bashkimi Evropian dhe me rezerva të thella nga ShBA-ja, sikur aktualisht paraqitet rasti i Kosovës. Për Kosovën çdo aleancë rajonale në rrafshin e sigurisë dhe mbrojtjes, derisa është nën ombrellën e NATO-s, është më tepër se e mirëseardhur. Mosanëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës është pasqyra më e kthjelltë - paraqet alarm se ku gjendet Kosova së trajtuari, edhe pse shumica e vendeve anëtare të KE-së e kanë njohur pavarësinë. Për Kosovën ishte rrethanë e favorshme - shto këtu edhe mungesën aktuale të Rusisë dhe disa vendeve jodashamirëse të Kosovës në KE.

Nuk është vërejtur këmbëngulje apo entuziazëm as nga institucionet e Kosovës në fazën finale, atëherë kur u duk se do të anëtarësohemi. Se çfarë ndodhi dhe pse arsyen e dinë më mirë ata që udhëhoqën këtë proces. Mund të marr parasysh se çfarë ka ndodhur dhe pse ka ndodhur, por jam i kufizuar të komentoj më shumë në këtë shënim.

Banjska? “Si ndodhi të shfaqen mbi 80 njerëz të uniformuar dhe të armatosur me dhjetëra kilometra në brendësi të territorit të Kosovës? Si ndodhi tolerimi i largimit të tyre qetësisht në pikë të ditës sikur të ishin ‘krushq të lirisë’ e jo sulmues të lirisë dhe shtetit?”

Duhet reflektuar pse edhe pas sulmit në Banjskë, Kosova u qortua nga ndërkombëtarët në rrafshin diplomatik dhe medial. Kritikat dhe presioni ndaj Beogradit ishin tepër elegantë. Edhe pas shpërthimit në kanalin e Ibër-Lepencit, përsëri fare lehtësisht në mediet ndërkombëtare qendrat vendosëse ngritën dilemën a ishte akt sabotazhi nga Serbia, apo veprim elektoral lokal. Askush nuk mund t'i fuste në



lajthitje mekanizmat ndërkombëtarë. Ata e kontrollojnë edhe tokën edhe qiellin e Kosovës. Kosova duhet të bashkëpunojë dhe jo t'i befasojë NATO-n dhe ShBA-në. Nuk është e rastësishme që këto ngjarje ndodhën pikërisht kur Kosova ishte në nivelin më të ulët të bashkëpunimit me Perëndimin. Do të duhej të ngrihet çështja për debat publik, analizë dhe përgjegjësi shtetërore. Pse pikërisht tani u guxua të ndodhin gjëra të tilla? Për 24 vjet Kosova nuk ishte ballafaquar me fenomene të tilla.

Kosova kishte në dorë edhe shkopin edhe karotën. Si ndodhi të shfaqen mbi 80 njerëz të uniformuar dhe të armatosur me dhjetëra kilometra në brendësi të territorit të Kosovës? Si ndodhi tolerimi i largimit të tyre qetësisht në pikë të ditës sikur të ishin “krushq të lirisë” e jo sulmues të lirisë dhe shtetit? Si erdhi deri te kjo ngjarje, vetëm drejtësia në bazë të një hetimi të thellë dhe të gjerë bashkërisht me ndërkombëtarët në një proces transparent mund ta zbardhë të vërtetën. Kosovës e vërteta i duhet më shumë në raport me ndërkombëtarët sesa për ta kënaqur opinionin publik lokal.

Adriatik Kelmendi: *Nga distanca që kenë, si do t'i vlerësonit marrëdhëniet e Kosovës me bashkësinë ndërkombëtare, para së gjithash, me ShBA-në dhe BE-në?*

Hashim Thaçi: Është shqetësuese. Vetëm dy njohje dhe asnjë anëtarësim i Kosovës në organizatat ndërkombëtare në gati pesë vitet e fundit. Koha e administratës së presidentit Biden shënon kohë dhe mundësi të humbur për Kosovën. Rikthimi i presidentit Trump paraqet mundësi të re të artë për Kosovën dhe gjithë Ballkanin Perëndimor. Trumpi është i përcaktuar qartë për paqe dhe bashkëpunim mes popujve.

Të rikujtojmë, njohja e parafundit Kosovës i erdhi nga Izraeli, me punën dhe angazhimin e drejtpërdrejtë të

presidentit Trump dhe ambasadorit Grenell.

Presidenti Trump e njeh Kosovën. Në takimet gjatë mandatit të parë presidencial më ka thënë: “Kosova është një vend i mrekullueshëm me popull të shkëlqyer”. Edhe mesazhi i fundit drejtuar popullit të Kosovës më 17 shkurt të këtij viti nga Trumpi ishte shumë inkurajues. Disa prej zyrtarëve të lartë aktualë në Uashington janë të përfshirë për kohë të gjatë me çështjen e Kosovës dhe shqiptarëve në përgjithësi. Ata nuk veprojnë pa i vënë dikush në lëvizje. Në këtë drejtim do të ishte me interes të ndodhte një koordinim mes Prishtinës dhe Tiranës. Shqipëria po tregohet më efektive.

Sot bota e trajton Serbinë ndryshe nga koha e konflikteve të ish-Jugosllavisë. Uashingtoni, Brukseli dhe vendet e tjera nuk e shohin Beogradin me optikën apo disponimin e Prishtinës dhe e kundërta. Perëndimi sot e shikon Serbinë në nuanca më të theksuara mundësie, përqendrimi dhe investimi ekonomik e ka më pak simpati për të kaluarën viktimizuese të Kosovës. Është më mirë një Serbi në Evropë dhe NATO, por jo pa e njohur Kosovën, kjo do të nënkuptonte më pak ndikim të Rusisë dhe Kinës në Ballkan. I kemi përjetuar baticat dhe zbaticat e sjelljes së Serbisë në raport me shqiptarët në tërësi apo edhe fqinjët e tyre kroatë, boshnjakë, malazezë apo edhe me komunitetet etnike brenda Serbisë.

Mungesa e Rusisë rreth katër vjet në tavolinat e qendrave vendimmarrëse botërore ishte mundësi e pashfrytëzuar nga Kosova. Fatkeqësisht, ora për Kosovën në këtë pikë dita-ditës po ikën. Më herët në çdo rast që është kërkuar nga pala e Kosovës prania e drejtpërdrejtë e ShBA-së në tavolinën e negociatave në Bruksel, Serbia kërkonte këmbëngulësish si balancë praninë e Rusisë. Kjo ishte e papranueshme për ne dhe partnerët tanë.

Kjo ndodhi, qëkur nga Asambleja e Përgjithshme e

OKB-së, në vitin 2011, Bashkimi Evropian u ngarkua me rolin e lehtësuesit të negociatave, (si produkt Marrëveshja 2013-2015 në Bruksel, si dhe së fundi deklarata apo marrëveshja shtesë e Ohrit).

Ndërkohë bota është polarizuar si kurrë më parë. Duke shpresuar se Trumpi, i ndihmuar edhe nga evropianët, do ta arrijë paqen në mes të Rusisë dhe Ukrainës, Lindjen e Mesme dhe vë në binarë edhe Iranin.

Rusia kurrë nuk ka qenë inkurajuese për marrëveshjen përfundimtare Kosovë - Serbi e as për integrimin e serbëve në institucionet e Kosovës. Por, për fat të mirë, integrimi ndodhi me sukses të vlerësuar për një dekadë të plotë 2013-2022.

Nga shkurti 2022, ShBA-ja, Bashkimi Evropian dhe NATO dhe aleatët e tyre nuk e kishin nëpër këmbë Rusinë. E dinin çka mendon dhe si vepron për Kosovën. Perëndimi nuk lejonte të binte në lajthitje nga Putini. Por, bota sot nuk është as për së afërmi e bashkuar për Kosovën sikurse që ishte deri para pak vitesh. Kjo është një e vërtetë e hidhur.

Të kërkohet njohja e Kosovës nga Ukraina dhe Siria

Është tragjike ajo që po vazhdon të ndodhë në Ukrainë. Solidariteti i kosovarëve me kauzën ukrainase është i drejtë, por Kosova është rast unik në historinë diplomatike, humanitare dhe ushtarake botërore. Zyrtarët e Kosovës duhet të kërkojnë nga Zelenski njohjen e Kosovës. E di se nuk është e lehtë tani për tani... do të ishte e shëndetshme për zyrtarët ukraianas që të mësohen me të drejtën e Kosovës. E pse jo edhe nga autoritet e reja të Sirisë. Një kohë, diku kah vera e vitit 2008, Asadi kishte deklaruar se nuk mund ta njohin Kosovën sepse hidhërohet Rusia. Tani gjërat kanë ndryshuar krejtësisht; kemi autoritete të reja në Damask, Rusia nuk ka çka

hidhërohet, sepse Asadi është larguar edhe vetë nga Siria, influenca e Iranit e rrëzuar. ShBA-ja, BE-ja, Turqia dhe Izraeli do ta mirëprisnin një vendim pozitiv për Kosovën. Lehtësimi i takimit nga presidenti Erdogan në Antalya në muajin prill mes presidentit të Kosovës dhe atij të Sirisë ishte veprim shumë i qëlluar.

Për një dekadë të tërë ishte temë tabu edhe njohja nga Izraeli, bile isha këshilluar edhe nga dy administrata amerikane, Obama - Biden, një dhe dy, që të mos i “ngushtoja” zyrtarët e Tel-Avivit për çështjen e njohjes së Kosovës, me arsyetimin “e kanë barrë Palestinën”. Nga ana tjetër autoritetet palestineze vend e pa vend, në çdo rast që u jepej, deklaroheshin agresivisht kundër pavarësisë së Kosovës. Ishte krijuar rrethanë paradoksale. Trumpi ishte ai që theu këtë tabu. Por nga ai moment çështja e njohjeve të reja ngriu.

Duhet qartësuar se as në rrafshin faktik e as në atë gjeostrategjik Kosova nuk është Ukrainë, as Serbia nuk trajtohet nga bota si Rusi. Ta krahasosh Kosovën me Ukrainën është qesharake, ndërkohë që Serbia është vendi nga rajoni që më së shumti e furnizoi me logjistikë luftarake Ukrainën. Kjo çështje për Serbinë nuk ishte vetëm komerciale, por ishte strategjike me dijeninë - lejen perëndimore, prandaj nuk është edhe befasi tolerimi i mosvënies së sanksioneve nga Serbia kundër Rusisë.

Nga konflikti Rusi - Ukrainë, Rusia u sanksionua nga Perëndimi.

Nga ngërçi në dialogun e Brukselit, masa ndëshkuese u nxorën kundër Kosovës e jo Serbisë.

Në retrospektivë, Rambuje 1999 dhe Vjenë 2005-08, ndodhi e kundërta.

Kujto këtu edhe opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në korrik 2010.

Kosova u tregua e përgjegjshme, ishte në anën e drejtë të historisë, u vlerësua dhe trajtua meritueshëm nga Perëndimi.

Unë besoj, mirënjohja e popullit të Kosovës për Perëndimin është e rrënjosur thellë dhe e përjetshme. Mosmirënjohja do të ishte e meta më e madhe morale me pasoja për shtetin.

“Nuk do të çuditesha... që Brukseli për Serbinë, ta përvijojë në mënyrë elegante standardin apo kushtin për njohjen e Kosovës si parakusht për anëtarësimin në Bashkim Evropian”

Bashkimi Evropian do të jetë i hapur për palët, vetëm me sjellje dhe veprime evropiane e jo pickuese ballkanase. Kjo do

të ishte rruga normale. Por nuk do të çuditesha dhe befasohesha me trendin e zhvillimeve aktuale, që Brukseli për Serbinë ta përvijojë në mënyrë elegante standardin apo kushtin për njohjen e Kosovës si parakusht për anëtarësimin në Bashkim Evropian. Brukseli do të duhej ta gjente rrugën më të shpejtë dhe efikase të evropianizimit të gjithë Evropës.

Znj. Kallas i kupton këto gjëra shumë mirë, varet sa do të ketë përkrahje nga shtetet anëtare të BE-së si përcaktuese të orientimit dhe dinamikës së politikave zgjeruese të BE-së. Duket qartë që edhe ndryshimet presidenciale në ShBA e gjetën Serbinë më të përgatitur sesa Kosovën. Dikush në Prishtinë do të duhej të mendojë racionalisht dhe strategjikisht për këtë.

Janë të pajustificueshme të ndodhin sanksionet e Brukselit. Kjo ka sjellë një ambient të gjithanshëm negativ në raport me Kosovën.

“Është jetik për shtetin e Kosovës rikthimi i serbëve në institucionet lokale, qeveri, parlament, polici, sistemin e drejtësisë, shëndetësi, arsim etj.”

Është jetik për shtetin e Kosovës rikthimi i serbëve në institucionet lokale, qeveri, parlament, polici, sistemin e drejtësisë, shëndetësi, arsim etj. Vetëm integrimi i tyre nënkupton sukses për Kosovën, gjithçka tjetër do të ishte dështim i brendshëm me pasoja për integrimet euroatlantike.

Zëvendësimi i integritetit me çfarëdo mekanizmi autonom nuk do të jetë as më shumë e as më pak sesa një “Republika Serbska”. Rintegrimi i serbëve është edhe obligim kushtetues, ligjor dhe qytetar. Tash po afrohen zgjedhjet lokale. Institucionet e Kosovës shpresoj të bëjnë çmos për një dialog me komunitetin e serbëve për inkurajimin e tyre për pjesëmarrje në zgjedhje. Ata duhet të udhëhiqen nga njerëzit e tyre të zgjedhur në mënyrë demokratike.

Kur ende duket se janë në veprim të përbashkët përfaqësuesit e ShBA-së, BE-së, Anglisë, Francës, Italisë dhe Gjermanisë, do të duhej të ndodhte përparimi.

Një angazhim kaq dinamik i faktorëve ndërkombëtarë ndodh rrallë për ndonjë vend apo rajon. Është mundësi unike. Ndoshta në të ardhmen edhe mund të lëkundet.

Vetmia eventuale për një shtet apo shoqëri, qoftë edhe e përkohshme, përcillet me pasoja. Është e rrezikshme. Politika e Kosovës nuk duhet të



jetë përpëlitesë. Shteti ynë nuk duhet të lejojë të vetëzhvlerësohet.

Duhet ta vazhdojnë rrugëtimin e tri dekadave të fundit, atë të rikthimit dhe ringritjes së identitetit tonë me qytetërimin perëndimor. Edhe mund të ketë mbetur ende erë, mjegull dhe myk i mentalitetit jozhvillimor apo paragjykimin në raport me Perëndimin, megjithatë gjërat do të duhej të kthjelloheshin më shpejt. Me ide të vjetra nuk mund të ndërtohen rrethana të reja.

Jam fundamentalisht optimist për të sotmen dhe të ardhmen. Shpresa më ka përcjellë në të gjitha fazat e jetës sime, nuk më ka braktisur as sot, në veçanti për një të burgosur nuk venitet kurrë. E keqja e përjetuar deri në fund të shekullit të kaluar për qytetarët e Kosovës do të mbetet në kujtesë historike.

Jam i bindur, kohët e mira për Kosovën janë para.

Adriatik Kelmendi: *A mendoni se gjeneratat e reja sot e kuptojnë plotësisht rolin tuaj dhe të bashkëlufëtareve tuaj për vendin? Apo a mos po tentohet të rishkruhet në mungesë tuajën edhe historia e Kosovës?*

Hashim Thaçi: Si student kam përfaqësuar vizionin se pa liri nuk mund të ndërtonim demokraci. Nuk mund të flitej për paqe pa liri. Pa liri nuk kishte vlerë asgjë. Jeta po humbiste çdo kuptim. Të pretendosh të sillesh i lirë kur mungon paqja ishte vetëmashtrim, madje edhe djallëzi.

Kam qenë përcaktuar për fitore dhe paqe, jo të pajtohem me diskriminimin në paqe të rrejshme në dëm të fitores së vërtetë. Jam treguar jokonformist. Njerëzit nuk kishin frikë, por po adaptoheshin me status-quo të shpresës së rrejshme, sikur gjërat do të vetërregulloheshin. Për veten time mendoja se e dija kah po shkoja dhe kisha qëllim. Me bindje politike jam formuar përtej ndikimit të ambientit që na rrethonte. Rezistenca jonë e ka formësuar rrethin shoqëror dhe ka lidhur

faktorët përcaktues me kauzën tonë.

Kam qenë në kërkim të rrugëve për ndryshimin dhe krijimin e faktorëve dhe rrethanave të reja - më të favorshme për vendin. Ishte rruga me e vështirë dhe rrezikshme që njeriu kosovar mund ta zgjidhte. Na mungonin mjetet, por idenë e kishim të mirë, qëllimin e qartë, vendosmërinë e palëkundur. Mënyra e zbatimit të qëllimit tonë u tregua impresionuese dhe bashkuese për gjithë kombin si asnjëherë më parë. Qëllimi ynë aq sa ishte i drejtë, ishte edhe civil dhe human. Gjatë rrugëtimit kishim plot arsye të ndiheshim hezitues, të lëkundur e në momente të caktuara edhe të dëshpëruar; ishte rrugë me plot gjemba e pengesa të njohura e të panjohura. Sfidat më madhe ishte thyerja e tabusë, se a mund ta realizonim lirinë e plotë. Shumica e njerëzve e dëshironin dhe punonin, por nuk arritën ta bindin veten se mund të bëheshim të pavarur pas rreth gati një shekulli robëri dhe dhune. Në momentin që arritëm ta fitonim betejën me veten tonë, triumfi ishte i paevitueshëm dhe i sigurt. Kështu ndodhi kthesa më e madhe politike në historinë tonë. Ideja e lirisë u shndërrua në mision qytetar.

Deri në vitet e rezistencës aktive posedonim si popull trashëgimi të përpjekjeve, sakrificave dhe viktimizimi, por jo trashëgimi fituesi. Tani duhej të fitonim. Qëllimi i lirisë ishte i madh dhe i drejtë. Atë që imagjinonim besonim se mund ta realizonim. Ideja e lirisë së Kosovës kishte tejkaluar kufijtë mentalë lokalë, gjeografikë dhe politikë të Kosovës. Ide që për herë të parë dëgjohej me simpati dhe interes edhe nga ndërkombëtarët. Transformuam shprehinë e heshtjes, ankesës, dëshpërimit, vajtimin në masë të theksuar dhe dorëzimit përballë gjendjes së keqe, me ngritje të zërit, optimizmit, dinjitetit dhe veprimit me besim në fitore. Suksesi i Kosovës është i pakthyeshëm dhe i papërsëritshëm.

“Duhet ndarë mandatet qeveritare të kujtdo qoftë nga historia e lirisë së Kosovës... Historia e lirisë së Kosovës në rrafshin e brendshëm ka vetëm një pronar - ai është populli e jo individi si i veçuar”

Tregimet e historisë së Kosovës nuk ka nevojë të magjepsin, mitizohen, të ngjyrosen apo edhe fshihen; e kanë të vërtetën dhe realitetin, kujtimet reale dhe drejtësinë. Kujtimet krenare të popullit tonë nuk mund t'i ndryshojnë pavarësisht nga pretendimet për zbehjen, ndryshimin apo edhe mallkimin të nxitura nga kushdo, as nga sajatat në sallat gjyqësore. Dija e shoqërisë për realitetin e së kaluarës mund të keqpërdoret me keqinformime, keqinterpretime, por nuk mund të mundet nga injoranca, naiviteti apo çfarëdo tendence tjetër.

Rrëfimet historike nuk duhet të ekzagjerohen apo minimizohen sot e të bëhen të dëmshme për shoqërinë nesër. Ky proces do të përcillet nga një transformim normal historik dhe qytetar. Vlerat sociale si të çdo populli gjatë fazave të ndryshme ndryshojnë dhe evoluojnë. Është një realitet me kompleksitetet e veta rreth të vërtetës dhe fakteve, pastaj duhen marrë parasysh emocionet, vuajtjet, meritat, dëshirat dhe kënaqësia e njerëzve të gjeneratave të ndryshme. Ne nuk paraqesim përjashtim. Këto fenomene i kanë përcjellë edhe kombet me traditë në dije dhe të emancipuara në rrafshin kulturor, social apo edhe politik. Por, e vërteta është dhe mbetet më e fuqishme se mashtrimi.

Jemi vendi dhe shoqëria me historikun universal më deficitar në Evropë – rreth vetëm 55 vjet, rreth tri dekada liri dhe historik shtetëror 17-vjeçar. Edhe historia shqiptare është përcjellë dhe në përmasa të caktuar edhe ndërtuar, për çka edhe kemi pasur nevojë nga mite, gojëdhëna apo folklor. Por, sot

për gjithçka ekzistojnë faktet, aktorët dhe realitetet e jetuara e pothuajse edhe të shkruara.

Duhet ndarë mandatet qeveritare të kujtdo qoftë nga historia e lirisë së Kosovës. Njerëzit e çmuar e bëjnë historinë, ata me pikëpyetje përpiqen ta menaxhojnë apo kontrollojnë, por këto përpjekje konsumohen shpejt. I tret koha. Historia e lirisë së Kosovës në rrafshin e brendshëm ka vetëm një pronar: ai është populli e jo individi si i veçuar. Për veten time, nuk kam qenë vetëm ëndërrimtar i ëndrrave, por kam qenë edhe njeri i punës për realizimin e qëllimit. Jam krenar me të kaluarën, por jo nostalgjik. Jetoj për të ardhmen.

“Duhet pasur kujdes, mjafton që individë të një brezi ta gangrenizojnë shtetin dhe shoqërinë me pasoja dekadash për shërim civil dhe shtetëror. Nuk duhet lejuar që për agjenda afatshkurtra të cenohet qëllimi gjeopolitik afatgjatë”

Edhe para vitit 1999 nuk është ndalur asnjëherë rezistenca, por kurrë në histori nuk kemi vendosur për veten tonë. Qershori i vitit 1999 shënon për Kosovën vitin zero. Viti i lirisë, drejtësisë dhe demokracisë, i hapur për botën e lirë dhe i mundësive të papërdetura në tokën e Kosovës. Kosova u ndërtua si shtet nga themeli, për fat të mirë, me ekspertizën më të avancuar perëndimore.

Të vë në lëvizje në mbështetje të lirisë së një populli rreth dy milionë qytetarësh (shumica të përkatësisë së besimit islam) ShBA-në, NATO-n, BE-në dhe vendet e tjera demokratike, fillimisht dukej mision i pamundur. Ishte angazhim kolosal shumëdimensional - mrekullia ndodhi.

Prandaj duhet pasur kujdes, mjafton që individë të një brezi ta gangrenizojnë shtetin dhe shoqërinë me pasoja dekadash për shërim civil dhe shtetëror. Nuk duhet lejuar që për agjenda afatshkurtra të cenohet qëllimi gjeopolitik afatgjatë. Shtetin duhet ta forcojmë për të drejtën dhe të mirën tonë, e jo në urrejtje ndaj askujt.

Lirinë e fituar dhe shtetin e ndërtuar duhet trajtuar shumë seriozisht.

Kujtojmë, tragjeditë më të mëdha shqiptare ndodhën në periudhën e katrahurave të luftërave botërore, luftërave ballkanike, në gjysmën e parë të shekullit të kaluar dhe gjysmën e dytë të ndarjes së botës në bipolaritet, ku për fatin tragjik, edhe pse në shtete të ndryshme, hapësira ku jetojnë shqiptarët dhunshëm u vunë nën ndikimin e të keqes komuniste. Krizat botërore e as rajonale nuk kanë qenë dhe nuk



do të jenë në favor të shqiptarëve. Kosova fitoi kur bota kishte arritur maksimumin paqësor të shekullit 20.

Adriatik Kelmendi: *A ju mungon sot ajo që ju do të dëshironi të bënit, duke përfshirë edhe përfshirjen aktive në politikë?*

Hashim Thaçi: Nuk më mungon aktiviteti politik, ndoshta as unë politikës, megjithëse politika si zanat është shumë e mirë. Edhe pse sot paguaj çmim politik, mua më pëlqen dhe e dua. Politika në njëfarë mënyre është edhe obligim qytetar përderisa merr pjesë në votime apo edhe duke mos marrë pjesë fare në votim, deshe apo nuk deshe, njerëzit e politikës janë ata që marrin vendime për individin, kolektivitetin dhe vendin. Edhe nëse nuk merresh me politikë, politika ndikon në jetën e secilit. Të rinjtë dhe jo vetëm, duhet të merren e jo të jenë spektatorë apo komentatorë për fenomenet shoqërore. Vetëm përmes aktivizimit mund t'i ndryshojnë dhe udhëheqin gjërat që duan. Duke u bazuar edhe në përvojën personale, vlerësoj dhe çmoj shumë qytetarin e Kosovës për kodet etike dhe mençurinë politike - di kur të besojë dhe përkrahë një projekt politik, por edhe di kur të abstenojë, apo edhe ndëshkojë me votën e tyre. Qytetarin e Kosovës nuk mund ta mashtrojnë askush, se e ka shumë të kultivuar sensin politik. E ka mësuar më shumë nga zori sesa nga amfiteatrot universitare.

Unë për veten time, përmes politikës dhe diplomacisë, kam bërë gjërat më të mira për vendin. Politika e Kosovës për tri dekada, nga fillimi i viteve 1990, ishte në anën e së mirës, tolerancës, dialogut, paqes dhe zhvillimit. Është i vulosur fakti historik se liria dhe shteti i

Kosovës, mbi të gjitha, janë fitore politike dhe diplomatike, por ky sukses nuk do të arrihej kurrë pa aktivizimin e forcës fizike qytetare në terren. Do të trajtoheshim nga ndërkombëtarët vetëm në nivel të shqetësimit ndërkombëtar për shkeljen e të drejtave dhe lirive njerëzore. Kjo e dhënë nuk e shqetëson fare Slllobodan Millosheviqin.

Prandaj, rezistenca nuk ishte ndjenjë e shpërthimit emocional, apo e ndonjë pretendimi aventure heroike - liria dhe pavarësia ekskluzivisht ishin nevojë ekzistenciale dhe qëllim politik me standarde demokratike e formësuar qartësisht.

Adriatik Kelmendi: *Kur ju do ta rifitoni lirinë, krahas ribashkimit familjar, çfarë do të donit të bënit?*

Hashim Thaçi: Rikthimi në familje është i pasfidueshëm. Sa iu përket gjërave të tjera, do të bëj angazhim që buron nga pasioni im. Do të bëj atë që ma do zemra. Jeta politike nuk paraqet preokupim dhe nuk më mungon. Jam i tejpërmbushur. Kam qenë lider studentor, luftëtar lirie, shef opozite për vite, disa herë kryeministër, zv/kryeministër, ministër i Jashtëm dhe president. Detyrat para atdheut nuk kryhen deri në frymën e fundit të jetës. U përkulem gjithmonë qytetarëve të Kosovës për besimin që më dhanë për mbi dy dekada. Nuk paraqes garuesin e as rrezikun politik për askënd. Por, shërbimi publik është jeta ime.

Adriatik Kelmendi: *Si e shihni perspektivën personale dhe politike pas këtij procesi gjyqësor, pavarësisht prej vendimit?*

Hashim Thaçi: Ritheksoj, perspektivën personale e kam të lidhur krejtësisht me familjen. Sa

i përket relacionit me politikën, mund të them me siguri të plotë: nuk do të pretendoj të rikthehem shtigjeve dhe rrugëve që i kam kaluar. Kam në mendje ide në perspektive, por asnjëra nga ato nuk lidhen me politikën. Çdoherë do të jem në përkrahje të njerëzve dhe projekteve të mira. Nuk kornizohem politikisht. Gjithmonë e shfaq respektin maksimal për bashkudhëtarët me të cilët kaluam ballafaqime dhe shënuam suksese për të cilat ndihem shumë i nderuar. Do të bëj gjëra që i mungojnë dhe i duhen Kosovës.

Adriatik Kelmendi: *Cila do të ishte sot porosia kryesore e juaja për qytetarët e Kosovës?*

Hashim Thaçi: Mesazh nga qelia nuk e di a do të ketë kuptim, s'e di sa do të jetë i qëlluar apo edhe a do ta dëgjojë apo lexojë kush? Por meqë keni kërkuar, do të shfaq në formë mendimi.

Edhe sot përcjell dashuri për bashkëkombësit kudo që jetojnë. Respekt për partnerët ndërkombëtarë me të cilët bashkërisht siguroam dinjitetshëm ekzistencën, mbijetuam dhe arritëm qëllimin e ndërtimit të shtetit të Kosovës. Deri para pak kohësh ishim shtet dhe popull në ngritje, duke u respektuar nga të gjithë. Sot duhet pasur kujdes të mos i ngatërrojmë punët vetvetes - mendimi im është të rritet uniteti shtetformues dhe qytetar dhe me shumë besim në rrugëtimin dhe vlerat euroatlantike.

Adriatik Kelmendi: *Çfarë mesazhi do t'u dërgonit liderëve aktualë të Kosovës për shtyrjen përpara të vizionit tuaj për shtetin?*

Hashim Thaçi: Ripërsëris, shpreh vetëm opinion, të ketë më shumë dashuri për shtetin dhe popullin,

më shumë dialog, tolerancë, bashkëpunim, respekt për njëritjetrin. Dallimet politike do të duhej t'i shndërrojnë në motiv për punë më cilësore. Shteti mund të ndërtohet fuqishëm edhe ndërkundërshti, por këto kundërshti të kuptohen dhe respektohen si garë për punë më të mirë, e jo për ta penguar njëritjetrin, duke e paguar çmimin Kosova. Liderët janë të përkohshëm, Kosova është e përjetshme.

Shqipëria, pas tri dekadash me ngritjet dhe rëniet e veta, po e përmbyll në mënyrë mbresëlënëse tranzicionin demokratik. Sot Shqipëria është një vend i respektuar dhe i besueshëm nga bashkësia ndërkombëtare. Është nder kur shihje Shqipërinë t'i udhëhiqte takimet e Këshillit të Sigurimit, me agjendë të koordinuar me ShBA-në dhe fuqitë e tjera perëndimore. Shqipëria e zhveshi para botës agresionin rus në Ukrainë. Shqipëria e mbështeti, mbrojti dhe afirmoi fuqishëm dhe dinjitetshëm shtetin e Kosovës.

Shteti i Kosovës duhet t'i kontribuojë fuqizimit të Shqipërisë, e jo ngatërimit të saj në rrugën evropiane. Shqipëria të mos kuptohet dhe trajtohet me mentalitet të lagjes së një cepi kombëtar, por në rrafshin gjeopolitik, ashtu siç edhe është - shtet i respektuar anëtar i NATO-s.

Sot roli i Shqipërisë në rajon është lider në iniciativa për paqe dhe zhvillim.

Shqipëria me gjithë vështirësitë ka rienergizuar konsolidimin e institucioneve demokratike, po i fuqizon reformat në politikë, drejtësi dhe ekonomi. Me këtë ecje është në rrugë të sigurt dhe të shpejtë për anëtarësim në Bashkim Evropian.

I mbetet vetëm standardizimi evropian.

Shih vonesat që po iu ndodhin Serbisë, Mali të Zi, Bosnjë-Hercegovinës, Maqedonisë... të gjithë ishin para Shqipërisë, po ndërruan pozicionet. Shqipëria po udhëheq bindshëm rrugëtimin evropian nga vendet e rajonit.

Pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, zotimi i kryeministrit Rama për ta organizuar Samitin e NATO-s në Tiranë në 2027 është impresiv dhe historik, jo vetëm për Shqipërinë, por për gjithë Ballkanin Perëndimor.

Shqipëria, nga vetëm pak vjet më parë shtet i përçmuar dhe i tallur nga shumë anë, sot është shndërruar në adresë shembull i mirë i ndërtimit të historisë euroatlantike.

Vrullshëm Shqipëria po bëhet atraktive. Është fantastike të lexoj artikuj apo të shoh dokumentarë në mediumet më prestigjioze të botës për impresionin e turizmit historik-kulturor, bregdetar, malor, me plot bukuri dhe mundësi të reja.

Të gjithë këta faktorë dhe të tjerë e kanë bërë Shqipërinë më të qasshme, më komode e më konkurruese.

Pengesa të vetme për vonesat eventuale për një të ardhme të shkëlqyer për Shqipërinë dhe Kosovën mund të jenë vetëm shqiptaret.

Shqipëria sot është në drejtimin e duhur, e destinuar të ketë të ardhme të sigurt perëndimore. Edi Rama po dëshmon vizion të shëndetshëm e modern me plot optimizëm dhe besim.

Edi po transformon dhe emancipon Shqipërinë dhe shqiptarët.

Edi po e bën historinë evropiane të shqiptarëve.





KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “ PASTRIMI” SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM “Pastrimi” Sh. A., konkretisht Nenin 11 dhe 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM “Pastrimi” SH.A si dhe në Plotësim – Ndryshimin e Rregullores nr. 01/2024 të aprovuar më 01.07.2025 me numër protokoll 01/14/26 konkretisht Neni 1 dhe 2 pozitat Punëtor i Bartjes dhe Punëtor i Higjienës Publike lirohen nga kriteri i përvojës së punës, me Vendimin nr.7096 të datës 15.11.2024 dhe nenit 20, pika 2 të Rregullores 07/2024, këto pozita lirohen nga testimi dhe në bazë të Vendimit të datës 25.07.2025 me numër të protokollit 02/01/548 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM “Pastrimi” SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të Punës:	Punëtor i Bartjes në KRM “Pastrimi” SH.A
Nr. i kërkuar:	Shtatëmbëdhjetë (17) pozita, Njësia Operative Prishtinë
Numri i Referencës:	NJOPR/KJ/20/2025
Koeficienti/Paga mujore:	Niveli XIII
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës:	Me kohë të pa caktuar
Periudha Provuese:	3 muaj

1. Detvrat dhe Përgjegjësitë:

- Bënë mbledhjen e mbeturinave në zonat e caktuara;
- Bënë zbrazjen e kontejnerëve në automjet/kamion;
- Bënë pastrimin e zonës përreth kontejnerëve;
- Bazuar në planin operativ dhe urdhëresës së punës bënë pastrimin dhe larjen e rrugëve dhe trotuareve;
- Bënë pastrimin e trotuareve dhe rrugëve nga bora dhe hedhjen e kripës;
- Bënë largimin e kafshëve të ngordhura nga rruga dhe vendosjen e tyre ne kontejnerin përkatës;
- Është përgjegjës për mirësjellje ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të kompanisë;
- Është përgjegjës që pas mbledhjes së mbeturinave, kontejnerët ti vendosë në vendin paraprak;
- Kujdeset dhe është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të mjeteve të punës dhe kontejnerëve;
- Kryen edhe punë të tjera me të cilat e angazhon udhëheqësi;
- Për punën e tij i raporton Udhëheqësit të Njesisë së Bartjes në Prishtinë.

2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detvrë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Shkollim i mesëm ose fillorë

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
CV - në	✓
Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore	✓
Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)	✓
Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)	✓
Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)	✓
Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës	✓
Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale, JO më të vjetër se 6 muaj	✓

6. Mënyra e aplikimit në konkurs:

- 6.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:
- duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A.
 - në Zyrat e Burimeve Njerëzore në KRM “ Pastrimi” SH.A.

- 6.2 Dorëzimi i aplikacionit bëhet:
- vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com

7. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik;

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 26/07/2025 deri me datën 17/08/2025.

Koha e fundit e pranimi të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit shkrim dhe me intervistim (testi me gojë).

- CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në njëzet e pesë (25) pikë;
- Intervista (testi me goje) vlerësohet deri në shtatëdhjetë e pesë (75) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronit dhe individualisht.

10. Kalendar i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,

Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Nextlight Software Solutions” L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812012889 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Nextlight Software Solutions” L.L.C. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812012889 ujedno imenovao Likvidatora o sprovedjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Nextlight Software Solutions” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 812012889 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" D. A

Na osnovu Zakona o radu br. 03 / L-212, posebno člana 8, u Uredbi br. 07/2024 o radnom odnosu u CRM "Čišćenje" a.d., tačnije članovi 11. i 12., u Uredbi broj 01/2024 o unutrašnjem uređenju i sistematizaciji radnih mesta u RPO "PASTRIMI" a.d. A kao i u Dodatku – Izmena i dopuna Uredbe br. 01/2024 odobreno 01.07.2025. godine sa protokolom broj 01/14/26 tačnije član 1. i 2. radna mesta radna mesta radnika u saobraćaju i radnika u javnoj higijeni izuzeta su od kriterijuma radnog iskustva, Odlukom br. 7096 od 15.11.2024. godine i članom 20. tačka 2. Uredbe 07/2024, ova radna mesta su izuzeta od testiranja i na osnovu Rešenja od 25.07.2025. godine sa brojem protokola 02/01/548 izvršnog direktora RPO "PASTRIMI" D. A, objavite ovo:

JAVNI KONKURS
Za popunjavanje posla

Naziv posla:	Radnik za nošenje u RPO "PASTRIMI" D. A
Ne. Obavezno:	Sedamnaest (17) pozicija, Operativna jedinica Priština
Referentni broj:	NJOPR/KJ/20/2025
Koeficijenti / Mesečne plate:	Nivo XIII
Trajanje ugovora o radu:	Sa neodređenim vremenom
Probni rok:	3 meseca

1. Dužnosti i odgovornosti:

- Sakupljali su smeće u određenim oblastima;
- Ispraznili su kontejnere u vozilu / kamionu;
- Uradili su ciscenje prostora oko kontejnera;
- Na osnovu operativnog plana i radnog naloga, očistili su i oprali ulice i trotoare;
- Očistili su trotoare i ulice od snega i bacali so;
- Uklonili su mrtve životinje sa puta i stavili ih u odgovarajući kontejner;
- Odgovoran je za ljubaznost prema građanima i korisnicima usluga kompanije;
- Odgovorno je da se nakon sakupljanja otpada kontejneri postavljaju na prethodno mesto;
- Brine se i odgovoran je za pažljivo korišćenje radnih alata i kontejnera;
- On takođe obavlja i druge zadatke sa kojima ga vođa angažuje;
- O svom radu izveštava šefa Transportne jedinice u Prištini.

2. Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:

- biti državljanin Republike Kosovo,
- da poseduju najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- Biti e/sposoban za obavljanje relevantne dužnosti;
- Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
- Ne bi trebalo da postoji disciplinska mera na snazi za ozbiljne prekršaje u javnoj ustanovi;
- Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju
- Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene u zakonu.

3. Opšti formalni zahtevi

- Potrebno obrazovanje: Srednje ili osnovno obrazovanje

4. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- Vještine logičkog zaključivanja i analize;
- Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- Istraživanje, analitičke, evaluativne veštine i formulisanje stručnih preporuka i saveta;
- Sposobnost donošenja nezavisnih stručnih presuda i diskrecionog prava o pitanjima i davanja značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politike;
- Opsežno poznavanje oblasti, istraživačkih metoda, što pomaže u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

5. Dokumenti koji se podnose u okviru prijave i kako ih dostaviti

Prijava popunjena i potpisana od strane kandidata	✓
CV - u	✓
Kopije diploma koje dodeljuju obrazovne ustanove	✓
Kopija dokaza o zaposlenju (penzioni fond, potvrda ili ugovor o radu)	✓
Kopija sertifikata o obuci i kursu (poželjno)	✓
Kopije procena posla za poslednje dve godine (poželjno)	✓
Kopija lične karte/pasoša/uverenja o državljanstvu Republike Kosovo	✓
Dokaz da nije osuđen za krivično delo, NE starije od 6 meseci	✓

6. Kako se prijaviti na takmičenje:

- 6.1 Povlačenje službenih obrazaca se vrši:
- preuzimanjem sa zvanične stranice na društvenoj mreži Facebook: Regionalna kompanija za otpad "PASTRIMI" AD.
 - u Kancelarijama za ljudske resurse KRM "PASTRIMI" a.d.

- 6.2 Podnošenje prijave vrši:
- samo elektronskim putem preko adrese: punesimi.krmpastrimi@gmail.com

7. tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa:

Javni konkurs traje 15 dana od 26/07/2025 do 17/08/2025.

Poslednji put za prijem prijava je 16:00 časova.

Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće se razmatrati.

8. Metod procene i kriterijumi ocenjivanja.

Kandidati se ocenjuju na osnovu biografije, pismenog testa i intervjua (usmeni test).

- CV kandidata se ocenjuje do dvadeset pet (25) bodova;
- Intervju (usmeni test) se ocenjuje do sedamdeset pet (75) bodova.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno sto (100) bodova, pri čemu je prolaznost postizanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog konkursa.

9. Kako obavestavati i komunicirati sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavesteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

10. Približan kalendar postupka zapošljavanja:

Faza pre verifikacije aplikacija do 7 dana;

Faza pismenog testa do 10 dana nakon faze verifikacije,

Faza intervjua do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.

Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon evaluacije intervjua.

Napomena: Nepotpuna, neskenirana dokumenta, kao i ona koja stižu nakon isteka roka konkursa neće biti razmatrana.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Erzen Tara shpall të pavlefshme diplomën e QK "11 Marsi", Prizren.

Krenare Kastrati shpall të pavlefshme dëftesën e klasës -IX- të SHFMU "Abdyl Frashëri", Prizren.

- ARBNORA HALITI, shpall te pavlefshme diplomën e SHMLM "Dr. Xheladin Deda".

- LEUTRIM ZYMERI, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM "Dr. Xheladin Deda".

- ERMIRA MURSELI, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM "Dr. Xheladin Deda".

- SPASENA RADOSAVLJEVIC B.I, shpall të humbur certifikatën e biznesit me numër unik identifikues: 810698631.

- Endrit Cena nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.M. "Hysni Zajmi", Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

